


PROJEKTI I DËGJIMIT

Raporti i Vizitave në Terren

Kosovë

Korrik 2007



Ky dokument është zhvilluar si pjesë e një projekti të përbashkët për mësim i drejtuar nga CDA. Raporti është pjesë e dokumenteve të mbledhura që duhet të konsiderohen si pjesë fillestare dhe të pjesërishme të projektit. Këto dokumente janë të shkruara për të lejuar identifikimin e çështjeve dhe temave të ndërlidhura me situata të ndryshme. Secili rast tregon qëndrimet dhe perspektivat e njerëzve të ndryshëm në kohën që është shkruar.

Këto dokumente nuk shfaqin produktin përfundimtar të projektit. Përderisa këto dokumente mund të citohen, ato mbesin dokumente punuese të përpjekjeve të mësimi të përbashkët. Gjeneralizime të përgjithshme rreth të arriturave të projektit nuk mund të bëhen prej një rasti.

CDA dëshiron të falënderon zemërgjerësinë e individëve dhe agjencioneve që ofruan kohën e tyre, përvojën dhe analizat për këto raporte, dhe për vullnetin e tyre për të ndarë përvojat e tyre.

Të gjitha dokumentet e shkruara për ndonjë projekt nuk janë bërë publike. Në ato raste kur njerëzit në atë zonë ku një raport është kryer kanë kërkuar nga ne që ta mbrojmë identitetin e tyre, ne kemi mbajtur ato dokumente private.

Konteksti i Projektit të Dëgjimit

CDA Projekti i Përbashkët për Dëgjim, me një numër të kolegëve në OJQ-ët ndërkombëtare dhe donatorët, ka filluar Projektin për Dëgjim për të ndërmarrë një hulumtim gjithëpërfshirës dhe sistematik të ideve dhe mendimeve të njerëzve që kanë qenë në anën e marrësit të ndihmës ndërkombëtare. Ata njerëz që punojnë përtej kufijve në fushën e ndihmës humanitare, asistencës për zhvillim, qeveri, të drejtat humanitare, ndërtim paqe dhe misione tjera kanë mësuar shumë duke dëgjuar analizat dhe gjykimet e vendorëve se si ata reagojnë ndaj efekteve të menjëhershme dhe ato afat-gjate të asistencës ndërkombëtare.

Gjatë tre viteve, Projekti i Dëgjimit do të vizitoj deri në 20 lokacione, derisa Kosova do të jetë vendi i tetë. Projekti do të mbledhë përvojat e njerëzve dhe reagimet në të gjitha vendet, dhe do të identifikoj e shkaqet dhe temat përtej lokacioneve, dhe do të theksoj implikimet e rëndësishme për të përmirësuar ndikimin e përpjekjeve të asistencës ndërkombëtare.

Ekipet e Dëgjimit kanë qenë të përbëra nga stafi i agjencioneve të ndihmave ndërkombëtare dhe zyrtarët e CDA-së. Ekipet nuk kanë punuar nga pyetjet e parashtruara, anketat, dhe nuk kanë shfrytëzuar ndonjë protokoll paraprak të intervistimit. Por, ne ua kemi bërë me dije njerëzve se si individë të angazhuar në punën e asistencës ndërkombëtare, jemi të interesuar të dëgjojmë vlerësimet e tyre ndaj punës ndërkombëtare. Kemi kërkuar nga ata që të kalojnë pak qaste me ne për të na treguar opinionet dhe idetë e tyre. Ne nuk kemi përcaktuar tema të veçanta, por kemi zhvilluar biseda të hapura mbi shqetësimet e tyre dhe mbi perspektivën e tyre për sukseset dhe sfidat e efikasitetit të asistencës ndërkombëtare, pa përcaktuar tema të veçanta.

Shumë biseda janë mbajtur me një ose dy individë. Në raste tjera, grupe të mëdha janë formuar dhe bisedat brenda një grupi të vogël shpesh janë shndërruar në një diskutim të hapur brenda grupit. Në disa raste, bisedat nuk janë para-përgatitur, dhe Ekipi i Dëgjimit ka udhëtuar për të vizituar ndonjë komunitet dhe ka nxitur biseda me këndo që ishin të gatshëm, duke përfshirë edhe personat që nuk kanë marrë asistencë ndërkombëtare. Gjithashtu janë organizuar takime me zyrtarë të qeverisë dhe liderë tjerë vendorë.

Një proces i përbashkët i mësimi si ky varet tërësisht nga njerëzit që kanë gjetur kohë për të ndarë mendimet e tyre me ne, dhe nga angazhimi dhe kontributi domethënës i organizatave që kanë marrë pjesë. Ata që kanë qenë të angazhuar në Kosovë meritojnë mirënjohje të madhe për përkrahjen e tyre logjistike të përgjithshme dhe mendimet dhe përkushtimin e të gjitha agjencioneve dhe stafit të punëtorëve që kanë participuar në të dhe kanë përkrahur këtë projekt.

Projekti i Dëgjimit në Kosovë

Projekti i Dëgjimit në Kosovë ka zgjatur 10 ditë pune në terren gjatë qershorit/korrikut 2007. Organizatat si: Care International, Catholic Relief Services, Danish Refugee Council, Mercy Corps, Movimiento por la Paz el Desarme y la Libertad (MPDL), dhe Partners Kosova kanë bashkëpunuar me CDA-në në organizimin dhe mbarëvajtjen e punës në terren. Secila nga këto agjencione ka dërguar staf, fonde, dhe përkrahje tjetër të nevojshme (përkrahje logjistike, transportim, mikpritje, etj) për këtë projekt, dhe CDA ka dërguar 4 përfaqësues për të mbështetur këtë praktikë të dëgjimit me pjesëmarrjen e stafit nga 21 zyrtarë të organizatave pjesëmarrëse dhe

përkthyesit. Shtatë ekipe të “dëgjimit”, të përbërë nga kosovarët dhe stafi ndërkombëtar nga agjensione të ndryshme për ndihmë, lehtësues ndërkombëtar, dhe përkthyes të vendit, janë fokusuar në rajonet e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Pejës dhe Prizrenit.¹ Brenda këtyre rajoneve, ekipet e dëgjimit kanë vizituar gati në të gjitha 30 komunitat dhe kanë mbajtur më shumë se 190 biseda të kohëzgjatjes dhe hollësisë së ndryshme me rreth 300 njerëz. Ekipet janë munduar të mbledhin një perspektivë sa më të gjerë dhe të bisedojnë me njerëz të ndryshëm nga pozitat e ndryshme shoqërore (p.sh. fermer, amvisë, zyrtarë të qeverisë, krijues të politikave, përfaqësues të shoqërisë civile, biznesmen, mësues, doktor, avokat, etj). Ekipet e dëgjimit gjithashtu kanë dëgjuar njerëzit nga të gjitha grupet etnike në secilin lokacion të mundshëm, dhe kanë biseduar më njerëz të ndryshëm, të rinj e të vjetër, nga zonat urbane dhe rurale.

Ekipet e Dëgjimit duhet të lavdërohen për shumë orë të dedikuara në dëgjim dhe udhëtim, duke mbuluar shumicën e Kosovës. Sidoqoftë, pavarësisht përpjekjeve tona për të kontaktuar një numër më të gjerë të njerëzve, ne jemi të vetëdijshëm ajo që kemi dëgjuar është vetëm një pjesë e vogël e opinionëve dhe sugjerimeve të njerëzve të Kosovës. Derisa jo përfundimtare, ne ndiejmë se informacioni i prezantuar këtu bazohet në pikëpamje të shumta si dhe tregon në përgjithësi për brengosjet e njerëzve rreth asistencës ndërkombëtare në at kohë. Duhet të kihet parasysh se pikëpamjet dhe shqyrtimet e më poshtme nuk tregojnë pikëpamjet zyrtare të agjensioneve që kanë marrë pjesë.

Një shënim në Kontekstin e Asistencës Ndërkombëtare në Kosovë

Provinca Jugosllave e Kosovës është vënë nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara në qershor 1999, pas fushatës bombarduese të drejtuar nga NATO e cila mbaroi konfliktin e armatosur në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) dhe forcave të armatosura serbe. Para intervenimit të NATO's mbi 260,000 shqiptarë² të Kosovës janë zhvendosur brenda Kosovës dhe 200,000 kanë mbetur refugjatë. Gjate bombardimit të NATO's (Mars – Qershor 1999), rreth 10,000 njerëz janë vrarë, shumica shqiptarë të Kosovës të vrarë nga forcat Jugosllave, për afërsisht 863,000 civil kanë kërkuar ose me forcë janë bërë refugjatë jashtë Kosovës, dhe 590,000 tjerë janë zhvendosur³ brenda vendit. Shumica e shqiptarëve të Kosovës janë kthyer në shtëpitë e disa javë pas përfundimit të bombardimit. Pas vendosjes së forcave të NATO's (KFOR) pasoi një dhunë ndaj pakicave në vend që rezultoi në largimin e më shumë se 150,000 serbëve të Kosovës dhe nacionalitetit rom në drejtim të Kosovës veriore, Serbisë dhe Mal të Zi, ose në enklava të vogla etnike brenda Kosovës.⁴

¹ Ky dokument përdor drejtshkrim të gjuhës shqipe dhe serbe për emrat e komunave, konsistent me raportet, zyrat dhe dokumentet e donatorëve dhe agjencioneve. Drejtshkrimet shqipe janë të parat, të ndjekura nga ato Serbe.

² Gjatë gjithë raportit ne iu referohemi të gjithë shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës si K-shqiptarë dhe K-serb, respektivisht.

³ Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovë, Raporti për Kosovë: Konflikti, Reagimi Ndërkombëtar, Mësimet e mësuara (Oxford: Shtypi i Universitetit të Oxfordit, 2000), f.90

⁴ “Përpjekjet e Agjencioneve Anëtarë të Bashkëveprimit në Kosovë”:

<http://ëëë.interaction.org/kosovo/index.html#backgroundsummary>; Grupi Punues i Çështjeve Humanitare, Të dhënat e reja lidhur me Situatën në Kosovë, 11 Shtatori 2000, HIËG/00/3, i gatshëm në <http://ëëë.unhcr.org/cgi-bin/texis/vtx/home/opendoc.pdf?tbl=SUBSITES&id=3c63edc67>

Gjerë më tani në Kosovë janë dërguar rreth 3 miliard Euro në asistencë ndërkombëtare.⁵ Nga 1999-2001, asistencë ndërkombëtare është fokusuar në ndihma direkte për të ndihmuar banorët cilëve u janë shkatërruar shtëpitë dhe komunitetet (psh. Ndihma ushqimore, ndërtimin e shtëpive, përkrahje në bujqësi / bagëti, dru zjarri dhe pajisje të tjera jo ushqimore, mikrofinanca etj), gjithashtu në ofrimin e sigurisë dhe qeverisje. Pas kësaj faze fillestare humanitare e cila kryesisht u përqendrua në shumicën shqiptare,⁶ programet e ndihmave ndërruan kahje në përmirësimin e jetës së refugjatëve të kthyer dhe IDP (shqip: njerëzit e zhvendosur brenda vendit). Këto ndihma kryesisht u përqendruan në komunitetet minoritare që ikën pas bombardimit të NATO's. Shuma të konsiderueshme të fondeve nga donatorët, gjithashtu janë investuar në mbështetjen dhe reformimin e strukturave ekonomike, politike, dhe gjyqësore. Këto investime janë drejtuar kryesisht nga Misioni i KB-së në Kosovë (UNMIK) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).⁷

Një vendim nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në të ardhmen e statusit të Kosovës është pritur në fund të vitit 2006. Ky vendim është shtyrë vazhdimisht me shpresën se do të arrihet një zgjidhje e përkrahur bashkërisht nga qeveria kosovare dhe serbe si dhe komuniteti ndërkombëtar. Prandaj ende nuk është e qartë se cili do të jetë përfundimi i negociatave – dhe se si ky përfundim do të ndikoj në të ardhmen e asistencës ndërkombëtare për njerëzit dhe institucionet e Kosovës.

Në këtë ambient të paqartë, natyra e asistencës ndërkombëtare gjithashtu është duke ndryshuar. Një numër i konsiderueshëm i programeve financuese janë zvogëluar nga ana e donatorëve dhe OJQ-ve ndërkombëtare, dhe administrata e UNMIK-ut është duke u kthyer në një institucion më të vogël të Bashkimit Evropian.⁸ Varfëria dhe papunësia gjithashtu janë çështje të rëndësishme duke marrë parasysh se një milion të ri nuk shohin perspektivë për punë në këtë vend.⁹

Çka Kemi Dëgjuar

Temat që kanë dalë nga bisedat e Ekipeve të Dëgjimit rreth asistencës ndërkombëtare në Kosovë janë prezantuar më poshtë në dy kategori të gjëra: të ndërlidhura dhe të përgjithshme. Tri tema – statusi, paqja dhe siguria, dhe korrupsioni – u theksuan gjatë diskutimit lidhur me thuajse të gjitha çështjet. Me qëllim që ta prezantojmë një analizë koncize, Ekipi i Dëgjimit vendosi që në vend se

⁵ Janë disa të dhëna të ndryshme se sa asistencë ndërkombëtare ka marrë Kosova. Një prezantim i bërë për UNDP nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (hyrja në <http://www.devaid.org/index.cfm?module=Library&page=Document&DocumentID=5705>) tregon shpenzimet e donatorëve prej vitit 1999 deri 2005 në më shumë se €2.3 miliard. Raporti për Kosovën për Zhvillimin Njerëzor 2006, sidoqoftë, tregon se në vitin 2002 përkrahja e donatorëve ka arritur në €900 milion. Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i Kosovës #15 e tregon shifrën e asistencës ndërkombëtare në vitin 2006, ku ndihmat janë zvogëluar shumë, në €465 milion.

(<http://www.kosovo.undp.org/respository/docs/EËR15FinalENG.pdf>). Asnjë nga këto shifrat përfshijnë ndihmën nga OJQ-ët dhe burimet e tjera private. Duke pasur parasysh shifrat më të larta, plus financimin privat dhe shpenzimet ushtarake, shuma totale e asistencës së huaj në Kosovë është shumë më shumë se €3 miliard.

⁶ Popullata e Kosovës zakonisht llogaritet të jetë 90% Shqiptarë etnikë, dhe 10% Serb dhe minoritete tjera.

⁷ Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara UNDP, 2006 Raporti i Zhvillimit Njerëzor:

<http://www.undp.org/kosovo>

⁸ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Statusi Final i Kosovës faqe:

<http://ëëë.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=3225&l=1>

⁹ Faktet e Shpejta të Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të Kosovës #13, qershor 2006, UNDP, faqe 1.

t'i diskutoj veçanërisht të gjithë shembujt lidhur me statusin, paqen dhe sigurinë, dhe korrupsionin, do të ishte më mirë ti pranon ato si çështje kritike dhe të ndërlidhura që përmenden në gati të gjitha bisedat. Pasqyrimet shtesë dhe analizat nga anëtarët e Ekipit të Dëgjimit përshkruajnë secilën temë.

Një shënim i përgjithshëm

Temat e më poshtme kanë dalë nga Ekipet e Dëgjimit që janë mbajtur me njerëz të ndryshëm në Kosovë, dhe përfaqësojnë realitetin e atij çasti. Ekipi i Dëgjimit i ka grupuar këto tema sipas një kornize analitike që se më së miri lejon konsiderimin sistematik të çështjeve të diskutuara. Shembujt e zgjedhur, në formën e citateve dhe tregimeve, prezantohen këtu sepse janë shembuj tipik të shumë ngjarjeve të njëjta. Megjithatë, është me rëndësi për tu shënuar se serbët dhe shqiptarët e Kosovës kanë ofruar llojllojshmëri të pamjeve të cilat nganjëherë drejtpërdrejtë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Temat e ndërlidhura

Statusi

Në pyetjen rreth ndikimit të asistencës ndërkombëtare, çështja kryesore në mendjen e qytetarëve është statusi i Kosovës dhe mundësia e pavarësisë. Të frustruar nga vonimet dhe mënyra se si është trajtuar vendimi i statusit nga komuniteti ndërkombëtar, shumë shqiptarë të Kosovës kanë thënë:

“Kur të zgjidhet statusi... do të ketë më shumë investime të huaja dhe ekonomia do të përmirësohet; do të ketë më pak rrëmujë sa i përket burokracisë sepse aty do të ketë një pako të ligjeve; këto ligje do të jenë më efektive dhe do t'iu shërbejnë nevojave të njerëzve brenda Kosovës...”

“Jo vetëm ne dëshirojmë që të zgjidhet statusi. Ne nuk jemi të kënaqur me mënyrën se si është trajtuar kjo. Ne kemi qenë të dëshpëruar shumë herë dhe brengosemi se do të zhgënjehemi sërish. Diçka duhet të bëhet – pasi kemi pritur shumë.”

“Është si të jesh student dhe diplomimi është tërë kohën në mendjen tënde.”

“Gjithçka varet nga statusi dhe pavarësia...me pavarësi, mund t'iu tregojmë botës se ne dimë si të udhëheqim, t'iu tregojmë se ne mundemi të organizojmë një shtet.”

Nga pikëpamja e serbëve të Kosovës, çështja e statusit gjithashtu është një burim i frustrimit dhe pakënaqësisë, me gjithë dëshirën e tyre që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë. Shumë serbë të Kosovës gjithashtu janë të pa kënaqur me trajtimin e vendimit të statusit, ku shumë prej tyre thonë se:

“Nuk jam i kënaqur me punën e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë sepse ata nuk bëjnë asgjë për t'i kthyer serbët ose të zgjidhin çështjen e statusit të Kosovës në kahje të duhur.”

“Respektojeni KSKB-në (Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara). Anashkalimi i këtij institucioni do të nxisë largimin e serbëve... nuk duhet të lejohet asnjë vendim unilateral.”

“Nuk ka pasur ndonjë proces të kthimit për tetë vite... [Rezoluta e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara] 1244 nuk është përmbushur... dhe çështja e tretë është spastrimi etnik. Bashkësia ndërkombëtare nuk ka ndikuar aspak.”

“Para një muaji organizata ndërkombëtare ka ofruar ndihmë, por njerëzit e kanë kuptuar se kjo ndihmë është e lidhur me statusin prandaj edhe e kanë refuzuar... programet multi-etnike janë jo-efektive sepse ato varen nga statusi ... para pak kohe e pashë të drejtë të flas në gjuhën shqipe në takime multi-etnike, por me ardhjen e statusit nuk mundem.”

Pjesëtarët e minoriteteve të tjera etnike gjithashtu kanë shprehur indinjatë rreth statusit final, posaçërisht se a do të trajtohen të gjithë qytetarët njësoj në shtetin e ri kosovar. Përderisa sot Kosova është më stabile, atje besimi ende mungon dhe ekzistojnë shqetësime se a do të respektohen të drejtat e minoriteteve dhe prona, dhe se a do të jetë qeveria gjithëpërfshirëse.

Disa njerëz janë të brengosur se komuniteti ndërkombëtar nuk ka bërë një punë të mjaftueshme për t'i ndihmuar njerëzit në rast të skenarëve të ndryshme. Disa thanë se ata nuk kanë informata të sakta rreth planeve për vendosjen e statusit dhe pasojat e opsioneve të ndryshme për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Siç tha një zyrtar komune:

“Aty ku nuk ka transparencë, gjithmonë ka hapësirë për dyshim. Merre Negocimin e statusit: Unë gjithashtu kisha pas dëshirë të dijë nga niveli më i lart se çka po ndodh.”

Të tjerët kanë thënë se shtyrja e vendimit të statusit e ka shtyrë krizën e tyre të identitetit dhe e ka ngadalësuar progresin në shumë çështje. Njerëzit janë të frustruar se shtyrja e zgjidhjes së statusit ka rezultuar në jo-përputhshmërinë e implementimit të ligjeve dhe paqartësi rreth faktit se cili ligj ka autoritet – rregulloret e UNMIK-ut apo ligjet serbe. Njerëzit në të gjitha komunitetet kanë biseduar për problemet në marrjen e pensioneve dhe sfidat e qasjes ndaj strukturave paralele të qeverisjes dhe administrimit (të Kosovës, UNMIK-ut, dhe ato serbe). Të tjerët kanë theksuar padrejtësitë rreth shpërndarjes së ndihmave për serbet dhe shqiptarët e Kosovës, duke vënë në pah se pikëpamjet e donatorëve me fonde shpesh me forcë i kanë detyruar që pakicat të inkuadrohen në projekte. Sipas tyre, kjo ka shkaktuar probleme duke i futur të gjitha grupet minoritare bashkë. Në vijim kemi elaboruar secilën nga këto çështje.

A K – Anëtar shqiptar i parlamentit, tha se për shkak të mungesës së vullnetit politik të bashkësisë ndërkombëtare për të zgjidhur problemin e statusit, llojet e tjera të asistencës ndërkombëtare kanë qenë më pak efektive. Njerëzit theksuan mënyra të ndryshme se si gati të gjithë ndikohen nga çështja e statusit dhe se si ky problem ka pasojat të gjithanshme për të ardhmen e asistencës ndërkombëtare. Në bisedat me njerëzit e ndryshëm, shumica e qytetarëve ishin të mendimit se derisa statusi i Kosovës të jetë i pazgjidhur, zhvillimi ekonomik do të jetë i kufizuar apo thjeshtë i pamundur.

Paqja dhe Sigurimi

Shumë njerëz cekën përpjekjet ndërkombëtare për të promovuar një bashkë-jetesë paqësore dhe multietnike, posaçërisht në zonat etnike të përziera dhe në Mitrovicën veriore (zonë e kontrolluar nga serbët). Në shumicën e zonave, shumica mendonin se asistenca ndërkombëtare përkrahte një grup (serbët e Kosovës kundër shqiptarëve të Kosovës) kundër tjetrit – varësisht me kënd kemi folur – për shembull:

“Ne të gjithë jemi kosovarë, ligjet duhet të jenë të njëjta për të gjitha etnicitetet dhe të aplikohen njëjtë. Nuk më pëlqejnë fjalët: ‘posaçërisht për serbët.’ Pse tabelat në shkollat shqiptare janë të vendosura në gjuhën Shqipe dhe Serbe, por ato në shkollat serbe vetëm në gjuhën serbe?”

“Komuniteti ndërkombëtar nuk i ka trajtuar serbët dhe shqiptarët njëjtë. Të gjitha investimet e tyre iu janë dhënë shqiptarëve. Ne duhet të ishim trajtuar njëjtë.”

Disa njerëz kanë përmendur përpjekjet e bëra nga agjensionet ndërkombëtare për promovimin e paqes, bashkëjetesës dhe pajtimit. Në disa zona, njerëzit janë ndier se këto përpjekje ndihmojnë në punën e tyre profesionale duke i mundësuar atyre që të punojnë më qytetarë të etnive të dhe prapavijave të ndryshme. Sipas tyre këto ndihma kanë mundësuar krijimin e një ambienti më të shumëllojshëm. Sidoqoftë, në zona tjera, njerëzit theksuan se tranjimet dhe projektet e dedikuara ndërtimit të paqes kanë qenë humbje kohe.

Njerëzit në shumicën e komuniteteve gjithashtu kanë folur rreth sigurisë dhe lirisë së lëvizjes. Disa shqiptarë të Kosovës kanë thënë se vendosja e sigurisë është merita më e madhe e komunitetit ndërkombëtar, dhe se KFOR-i ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Sidoqoftë, disa kanë thënë se trafikimi i femrave dhe i drogës është shfaqur si rezultat i prezencës së madhe ndërkombëtare. Sipas tyre Kosova nuk është ballafaquar me këto probleme para vitit 1999.

Në disa vende, minoritetet thanë se ata tani ndihen të sigurt për të udhëtuar përreth komunave etnike dhe e kanë nënvizuar këtë si indikator të efikasitetit të komunitetit ndërkombëtar, posaçërisht si fryt i punës së KFOR-it në ofrimin e sigurisë. Sidoqoftë, në komunitetet tjera serbe, posaçërisht në Mitrovicën veriore, njerëzit theksuan si problem mungesën e qasjes në objekte dhe shërbime. Ata gjithashtu shprehen brengat e tyre lidhur me sigurinë e tyre:

“Ditët kalojnë dhe njerëzit duhet të ndihen të sigurt të qëndrojnë dhe jetojnë në Kosovë. Në njëfarë mënyre, nuk ka ndonjë përparim të dukshëm. Ne ende kemi liri të kufizuar të lëvizjes në enklava, mungesë të të drejtave themelore njerëzore ... disa nga shokët e mi të cilët jetojnë në enklava kanë probleme dhe ata kurrë nuk i kanë raportuar ato tek SHPK-ja [Shërbimi Policor i Kosovës] sepse janë frikësuar nga pasojat. Ne jetojmë në një shoqëri të korrumpuar kështu që njerëzit nuk presin shumë.”

“Nëse ka liri të lëvizjes në Kosovë, atëherë si është e mundur që sa herë që kam nevojë të shkoj në Prishtinë, më duhet të kërkoj përcjellje nga ndërkombëtarët? Pse unë nuk mund të udhëtoj me autobus lokal ose të përdori tabelat e regjistrimit në veturën time? Pse sa

herë që shkoj diku me ndërkombëtarë, ata duhet të nënshkruajnë letrën e cila thotë se nuk mbajnë përgjegjësi për jetën time?”

“Organizatave ndërkombëtare na kanë lidhur me donatorë dhe na kanë ndihmuar me regjistrimin e OJQ-ve, por të gjitha gjërat e rëndësishme kanë ndodhur në Prishtinë.”

“Nuk ka arsye të qëndroj për fëmijët ... ekziston një sindrom burgut tek njerëzit.”

“Pjesa jugore e Mitrovicës ka stacionin e autobusëve, stacionin hekurudhor, stadiumin e sporteve, muzeun, kinemanë, teatrin, dhe ana veriore nuk ka asgjë.”

“Njerëzit në anën veriore nuk e shohin komunitetin ndërkombëtar si burim.”

Ky zhgënjim me komunitetin ndërkombëtar ishte gjithashtu i bashkangjitur me vërejtjen e shpeshtë se tani është “shumë vonë,” dhe se “s’ka kthim mbrapa.”

Korrupsioni

Korrupsioni është përmendur shpesh në biseda në të gjitha rajonet dhe me njerëzit e të gjitha etnive. Shumica e dyshimeve dhe akuzave i drejtohet kosovarëve, ose stafit vendorë të organizatave ndërkombëtare, edhe pse në disa raste njerëzit janë ankuar rreth veprimeve (apo mosveprimeve) të zyrtarëve të huaj. Njerëzit shprehën shqetësimet ndaj zyrtarëve të lartë të komunitetit ndërkombëtar, duke thënë se ata është dashur të monitorojnë programe në mënyrë më efektive, të inkurajojnë transparencë, dhe zbatojnë ligjet dhe rregulloret për parandalimin e korrupsionit, si dhe të ofrojnë shembull të mirë.

Lidhur me pohimet rreth korrupsionit në financimin e projektit, Ekipet e Dëgjimit i kanë dëgjuar këto mendime:

“Kjo OJQ [OJQ ndërkombëtare] është si mafia. Ë ka ftuar tenderët nga një komunë lokale, dhe me gjasë ka marrë diku rreth 2 milion Euro nga donatorët. Por komunës më vonë i është thënë se kjo organizatë nuk punon në rajonin e Prishtinës.”

“Shpesh OJQ-ët punojnë me shuma të ndryshme të parave, por pastaj ata punojnë me më pak dhe të tjerat i fusin në xhep. P.sh. një i kthyer ka marrë një sharrë e cila kushton më së shumti €400 në treg, por atij i është dhënë llogari me çmim €1000.”

“Punën e organizatave ndërkombëtare e shoh si “Shpëlarje Parash. Për shembull, një organizatë ka investuar tre herë në të njëjtin projekt. Një donator e ka financuar punën e këtyre OJQ-ve, por investimi i tyre nuk është asgjë pos shpëlarje parash.”

“Ka shumë OJQ që ekzistojnë duke pasur vetëm një anëtar, duke mos pasur një zyre të rregullt, plane, ose edhe një kompjuter, dhe ata janë duke vënë kontakte për nevojat e tyre, sepse shumë donator nuk e dinë të vërtetën reale.”

Gjatë theksimit se korrupsioni nuk është gjë e re në Kosovë, por se shumica e të hollave ishte më e lartë dhe se ndërkombëtarët janë edhe më të zhdërvjellët gjatë keqpërdorimeve, një person tha:

“Nëse shumica ishte 7 shifrore, atëherë ishte një i huaj, nëse shumica ishte 6 shifrore, atëherë kishim të bënim më një kosovar.”

Një numër i njerëzve thanë se nuk ka pasur shumë ndryshime pozitive siç kanë pritur ata nga të gjitha ndihmat ndërkombëtare që kanë ardhur në Kosovë sepse korrupsioni është lejuar dhe ky problem nuk është marrë seriozisht. Disa njerëz të etnive të ndryshme rekomanduan se duhet të ketë auditor të huaj në shqyrtimin e ndihmave që iu janë dhënë agjencioneve ndërkombëtare dhe lokale si dhe qeverisë. Ata shtuan se nuk kanë besim tek stafi lokal dhe se kjo do të ndihmonte në zbatimin e standardeve dhe sigurimin e asistencës efektive. Duke i parë sfidat përpara, një qytetar tha:

“Korrupsioni është dukuri e zakonitë në kulturën tonë. Ndërkombëtarët nuk mundën ta ndryshojnë atë. Kosovarët duhet të marrin përgjegjësi. Ne duhet të marrim masat e duhura që të mos korruptohemi. Tranzicioni [nga administrata e UNMIK-ut] do të jetë i vështirë sepse ligjet mund të jenë konfuze ... më shumë mbikëqyrje nga komuniteti ndërkombëtar do ta ndihmonte këtë problem.”

Çështja e korrupsionit është në veçanti e adresuar në disa vende më poshtë. Sidoqoftë, këto instance ishin reflektim i problemit i cili është përmendur shumë herë, me efekte të jashtëzakonshme në kuantitetin, kualitetin, dhe efikasitetin e asistencës nga bashkësia ndërkombëtare në Kosovë.

Temat e Përgjithshme

I. Si Janë Ofruar Ndhimat

Në rajonet e Prizrenit dhe të Pejës, në të cilat një sasi e madhe dhe e rëndësishme e ndihmës ndërkombëtare i është dhënë veçanërisht shqiptarëve të Kosovës pas bombardimeve të NATO-s, Ekipet e Dëgjimit kanë dëgjuar një numër të madh komentesh pozitive për ndikimin dhe efikasitetin e asistencës ndërkombëtare. Në mënyrë të posaçme anëtarët e komunitetit shqiptarë nga Kosova thanë se përderisa ende ekzistojnë disa probleme të përmendura më parë, ata megjithatë ishin mjaft të kënaqur dhe njëkohësisht mirënjohës për praninë dhe paraqitjen e komunitetit ndërkombëtar dhe për ndihmën e përkrahjen e tyre të ofruar sidomos gjatë fazës emergjente (1999-2001).

Shqiptarët e Kosovës ishin më pak të kënaqur me periudhën pas fazës emergjente, megjithëse serbët e Kosovës dhe minoritetet e tjera në përgjithësi ishin të kënaqur me asistencën të cilën e kishin pranuar në kohën e fundit. Ky mendim mund të jetë rezultat i përqendrimit të fondeve prioritare drejtë përkrahjes së minoriteteve. Në rajonet e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës së Veriut, ku ka më shumë larmi etnike, ekzistonte një ndjenjë e fort e pakënaqësisë me asistencën ndërkombëtare, dhe shumë nga sfida e përmendura më lartë u cekën më shpesh.

Njerëzit në shumë vende ishin mirënjohës për ndihmat që kishin pranuar, duke thënë:

“Na shpëtuan jetën. Unë nuk e di nga të filloj, dhe kujt t’i falënderohem më përpara...”

“Unë dhe shumë njerëz të tjerë këtu jemi shumë të kënaqur. Njerëzit kanë kushte të jetesës më të mira.”

Megjithatë, atje zakonisht kishte edhe shprehje të zhgënjimit, siq ishte rasti i zyrtarit të qeverisë, i cili tha:

“Pa ndihmë, ne nuk do të kishim mundur të mbijetojmë dhe nuk do të kishte më jetë në Kosovë. Nuk është e drejtë të thuhet se nuk janë bërë ndryshime, por, çka ishte e mundur, nuk është realizuar.”

Disa çështje të ndryshme të theksuara gjatë këtyre bisedave lidhen me pyetjet se pse ”çka ishte e mundur” nuk është realizuar plotësisht. Këto mund të shqyrtohen duke shikuar komentet që njerëzit kanë bërë lidhur me: a) Njerëz dhe organizatat që ofruan asistencë, b) Çfarë ndihme është ofruar, c) Koordinimin, komunikimin, dhe pjesëmarrjen lidhur me asistencë, dhe d) Përgjegjësi e atyre që ofruan ndihmat.

A. Organizatat dhe Njerëzit të Cilët Ofruan Ndihma

Në përgjithësi, shumë njerëz kishin komente pozitive për stafin ndërkombëtarë me të cilët ata kishin bashkëpunuar, si dhe me praninë në komunitetin e tyre. Mirëpo, u shfaqën disa kritika ndaj organizatave ndërkombëtare dhe kontribuesve, veçanërisht lidhur me varshmërinë e tepërt në stafin dhe ekspertët e huaj. Qytetarët ngritën shqetësime lidhur me mënyrat se si këto organizata kanë investuar tepër resurse në staf, shpenzime e përgjithshme, takime dhe vizita, dhe shumë pak në komunitet në të cilat kanë vepruar. Ekipi i dëgjimit vlerësoi se këto perceptime janë prezentë nga qytetarët e të gjitha grupeve etnike.

Në një grup diskutimi, njerëzit ishin të mendimit se në një agjension ndërkombëtar gjysma e të hollave shpenzohet për rroga dhe administratë, bashkëpunëtorët e agjensionit shpenzojnë një të tretën në shpenzimet e tyre, dhe si rezultat komunitetet/përfituesit e ndihmave shohin vetëm një pjesë të vogël të fondit shpërndarës. Të tjerët ofruan komente të ngjajshme:

“Gjatë rrugëtimit të ndihmave prej burimit e deri në terren, vetëm 10% mbërrinë tek komunitetet... ky proces është shumë i gjatë, më shumë trajnime...”

“Një shumë e madhe e të hollave është shpenzuar në punë administrative, këshilltarë dhe procedurat burokratike.”

“Një shumë e madhe është shpenzuar për lëndë djegëse dhe staf, dhe vetëm 10% e të hollave është shpenzuar për programe.”

“NGO-të premtuan kthim, por nuk ndodhi asgjë...ata kishin koncepte të programeve...por thanë se “nuk ka se çfarë të bëhet këtu”. Që atëherë, ata veçëse kishin perdorur shumë të holla për vizita dhe dialogje.”

“Një ekspert i huaj kushton më shumë se një departament i tërë i stafit lokal. Të hollat do të mund të përdreshin për të rritur pagat e institucioneve vendore dhe kështu të punësonin njerëz të kualifikuar aty.”

Një numër i njerëzve diskutuan për ndërlidhjen logjike në mes të pagave të ulëta vendore dhe joshjen për tu korrptuar. Më tepër, aty kishte edhe zhgënjime në kualitetin e stafit ndërkombëtar të punësuar në Kosovë. Për shembull, disa njerëz thanë se duke marrë parasysh pagat e larta të ekspertëve të huaj, njerëzit kanë pritur më tepër ekspertizë e cila nuk është mundur të ofrohet nga një kosovar. Të tjerët shprehën shqetësimet me faktin se një pjesë e madhe e fondeve ndërkombëtare është kthyer në po ato vende donatore përmes pagave për ekspertët e huaj, dhe varshmërinë e madhe në këshilltarë dhe kontraktues të huaj.

Të tjerët ishin të ofenduar nga arroganca e disa zyrtarëve të huaj të cilët punonin për agjencionet ndërkombëtare, duke vlerësuar se disa prej tyre që nuk dinin se sa e zhvilluar është Kosova dhe se sa e shkolluar është popullata vendore, ishte dhe sa i edukuar ishte populli i tyre në përgjithësi. Sipas tyre zyrtarët e huaj shpesh i konsideronin vendorët si njerëz “primitiv” Të tjerët theksuan se kualiteti i personelit të huaj ishte i lartë gjatë fazës emergjente, por me kalimin e kohës organizatat e huaja në Kosovë filluan të angazhojnë zyrtarë më pak kompetent, profesional dhe të përkushtuar.

Një pjesë e njerëzve nga rajone të ndryshme theksuan faktin se ata nuk u kanë besuar stafit lokal të organizatave ndërkombëtare, dhe se duhet të njihnin dikë brenda organizatave për të gjetur punë apo për të marrë ndihma. Disa thanë që do të preferonin më tepër ndërkombëtarë dhe më pak staf lokal, duke besuar se ndihmat do të ishin më të paanshme nëse ndërkombëtarët do të angazhoheshin më tepër në vendim-marrje në nivelin lokal.

Posaçërisht në Mitrovicën e veriut, njerëzit me të cilët biseduam shprehën më tepër mosbesim dhe zhgënjim ndaj komunitetit ndërkombëtar të pranishëm në Kosovë. Në pyetjen se [farë janë përshtypjet e serbëve të Kosovës ndaj agjencioneve ndërkombëtare, një person deklaroi,

“Reagimi i parë është negativ dhe ka të bëjë me mosbesimin ndaj KFOR-it dhe ShBA-ve. Ka nevojë më të madhe për ndërtim të besimit në mes nesh dhe bashkësisë ndërkombëtare. Shumë ndërkombëtarë nuk kanë shpenzuar mjaft kohë për të fituar respektin e komunitetit vendor.”

Serbët e Kosovës theksuan shpesh zhgënjimin e tyre me mungesën e sensibilizimit dhe veprimeve të OJQ-ve ndërkombëtare për të zgjidhur problemet e tyre:

“Ne nuk jemi të sigurt për të ardhmen tonë në Kosovë. Serbët nuk ndihen si qytetarë të komunitetit kosovar sepse trajtohen sikur minoritete. Problemet e serbëve janë lënë anash dhe kjo është arsyeja pse njerëzit janë të zemëruar dhe kanë qëndrime negative ndaj ndërkombëtarëve...sepse ata kanë projekte, vizitojnë njerëz, i dëgjojnë ata, por gjithnjë thonë të njëjtën gjë:”Nuk varet nga ne, ne do të i shkruajmë por nuk mund të ju premtojmë asgjë sepse ju e dini se ne jemi grupe jo-qeveritare, dhe problemet e juaja duhet të merren parasysh dhe të adresohen nga ata me pozita më të larta.”

Mendimet e Ekipit të Dëgjimit mbi Organizatat dhe Njerëzit të Cilët Ofruan Asistencë

Në bisedime dhe analiza nga ana e Ekipit të Dëgjimit, ishte evidente se respekti, sensibilizimi kulturor, dhe marrëdhëniet e mirë me stafin ndërkombëtar të agjencive humanitare janë shumë të rëndësishme për anëtarët e komunitetit. Kjo është e logjikshme por edhe një përkujtim i mirë që njerëzit dëshirojnë që brengat dhe idetë e tyre të dëgjohen dhe të merren nën konsiderim. Marrësit e asistencës dëshirojnë që stafi dhe agjencitë ndërkombëtare të jenë të vetëdijshëm ndaj sfidave me të cilat këto komunitete ballafaqohen. Ata dëshirojnë që kjo të reflektohen gjatë programeve të agjencive.

B. Çka ishte siguruar

Njerëzit shpesh deklaruan se asistenca ndërkombëtare gjatë fazës emergjente të konfliktit ishte adekuate, e nevojshme, dhe se ka shpëtuar jetë. Në disa rajone shqiptare, sikurse Prizreni, pothuajse të gjithë komentuan që prezenca e komunitetit ndërkombëtarë është pranuar me një mirënjohje të madhe. Shumica e njerëzve theksuan rëndësinë e përkrahjes materiale për rindërtimin e shtëpive, ndihmat ushqimore etj. Ata gjithashtu cekën edhe rëndësinë e ndihmave tjera si prezenca së tyre dhe ofrimi i ndjenjës së solidaritetit dhe shoqërisë.

Një drejtor i një shkolle, i kënaqur me ndihmat e marra: tha

“Ne gjithashtu patëm mbështetje mendore e shpirtërore, e cila na ndihmoi tepër. Kjo ka ndikuar në familje të ndryshme për realizimin e marrëdhënieve më të mira. Gjithashtu ka pasur efekt të mirë në fëmijë, duke ndihmuar marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe mësuesve, ndërmjet burrave dhe grave. Ne gjithashtu kemi pasur trajnime për të drejtat e fëmijëve-Të gjitha këto pasur një efekt shumë pozitiv në jetën tonë.”

Një grua, Shefe Ekzekutive (Kryetare Komune) e një komune tregoi se si trajnimet mbi ndërtimin e kapaciteteve që ajo dhe stafi i saj i vijoj lidhur me shoqërinë civile, planin urbanistik, dhe zhvillimin lokal ekonomik ka qenë shumë të vlefshme për të si një udhëheqëse. Ajo gjithashtu shtoi se puna e bërë nga organizatat ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e femrave e ka mundësuar atë që të mbajë një pozitë lartë të komunitetin e saj. Edhe një zyrtar tjetër i komunës deklaroi se trajnimet mbi zgjidhjen e konflikteve kanë qenë të realizueshme falë prezencës së bashkësisë ndërkombëtare:

“[trajnimet për zgjidhje të konflikteve] më ndihmuan të bashkoj njerëz gjatë procesit të kthimit...[në seminar 1-3 ditësh] qeveritarë nga etni të ndryshme u mbledhën përreth tavolinës dhe krijuan marrëdhënie shoqërore të mira, mësuan të punojnë së bashku... pa këto dialogje dhe trajnime, ne s’do të mundeshim të pinim kafe së bashku dhe njëkohësisht të zbutnim konfliktet.”

Gjatë disa bisedave, njerëzit theksuan efikasitetin e përfshirjes së të rinjve në sport si një mekanizëm efikas për zbutjen e mospajtimeve. Ata përgëzuan bashkësinë ndërkombëtare për punën e mirë në përkrahjen e këtyre aktiviteteve:

“Gjithçka shkon mirë me sporte. Dje patëm një delegacion të të rinjve serbë, të cilët janë të mirëseardhur këtu. Sportet kanë më tepër efekt se sa bisedimet e thata.”

Për më tepër, edhe pse ekzistonte një mospajtim rreth rendit të dorëzimit të asistencës, shumica ishin të mendimit se ishte më efikase përqendrimi nga ndihmat e drejtpërdrejta në ndërtimin e kapaciteteve dhe organizimin e trajnimeve.

Megjithatë, shumë njerëz dhanë shembuj të shumëfishtë të dështimeve që ndihmat ndërkombëtare të përmbushin”nevojat” e komunitetit vendor. Kjo zbrazëti ishte e ndryshme, duke përfshirë dhënien e gjërave të panevojshme, ofrimi i ndihmave me motive politike, dhe ofrimi i trajnimeve të padobishme.

U cekën shumë raste kur grupe dhe organizata të ndryshme kanë marrë ndihma që nuk mund të përdoreshin (p.sh. barna me afat të skaduar). Një njeri theksoi se si gruaja e tij kishte fituar një makinë të qepjes por jo edhe trajnim. Ajo nuk kishte ide se si ta përdorë atë makinë dhe më pas e prishi. Një tjetër tregoi për ndërtimin e qendrës së shëndetësisë nga një agjension ndërkombëtar në komunitetin ku ai jetonte. Kur u pyet se si po shkonin punët atje, ai rrëfeu se ndërtesa nuk po shfrytëzohej si rezultat i mungesës së stafit:

“Agjensioni kontribuues asnjëherë nuk na ka pyetur se për [farë kemi nevojë, dhe komuniteti nuk desh të refuzoj një ofertë aq bujare edhe nëse ne nuk do t'i shfrytëzonin ato ndihma në atë moment. Ne shpresuam që një ditë do të dërgohet ndonjë doktor në atë komunitet dhe më pas do të hapej ajo qendër.”

Në anën tjetër, një anëtar i komunitetit tregoi se si një ndërkombëtar i një OJQ-je nga një vend i Lindjes së Mesme:

“...u dha kutia të ndryshme ngjyrash shkollave dhe pastaj u dhanë fëmijëve disa banderola që ti mbanin. Këto pllakate ishin në gjuhën Arabe dhe ne nuk i kuptuam. Ata dëshironin që fëmijët të merrnin pjesë në trajnime religjioze. Ata ndërtuan një xhami në vend të shtëpive. Çfarë është kuptimi i xhamisë kur nuk ke shtëpi të jetosh?”

Gjithashtu, disa njerëz përmendën trajnimet e shumta një, dy, tre ditore derisa papunësia në Kosovë është afër 50 përqind. Gjatë një bisede, një grua komentoi që trajnimi i ofruar ishte i padobishëm.

“...këto projekte të frizerave—kjo ishte një çmenduri --- të trajnohen 50 femra për frizerë në një fshat pa treg.”

Disa njerëz i konsideruan këto ndihma si ofendim të inteligjencës së tyre, duke thënë:

“Komuniteti ndërkombëtar ka keqkuptuar që ne jemi njerëz të civilizuar. Disa nga seminarët ishin të padobishëm – ne nuk mësuam asgjë të re dhe ajo ishte vetëm një humbje e të hollave...Të hollat mund të jenë investuar më mirë në arsim.”

“Ne kemi një popullatë të shkolluar. Shumë këshilla nuk kanë qenë të nevojshme. Nganjëherë, dituria e njerëzve që ofronin trajnime nuk ishte adekuate.”

Qytetarët shpesh theksuan se ata kanë nevojë më të madhe për përkrahje afatgjate dhe sistematike në zhvillimin e aftësive të tyre, dhe patjetër ofrimin e shanseve të qëndrueshme ekonomike në vend të trajnimeve të kohë pas-kohshme.

C. Çështjet e Koordinimit, Komunikimit, dhe Pjesëmarrjes

Njerëzit shpesh shtruan pyetjen, *“Ku shkuan tërë ato fonde?”* Mendimet e tyre rreth shpenzimit të fondeve të bashkësisë ndërkombëtare janë të ndryshme: në disa raste, njerëzit thanë se përgjigja ishte në korrupsion, me fjalë të tjera, ishte fakt (që ishte përfolur më lartë) ku shumë organizata ndërkombëtare përvetësuan disa fonde prej asistencës që ti mbulojnë shpenzimet e tyre. Megjithatë, shumica e njerëzve menduan se shumica e fondeve në Kosovë nuk është përdorur në mënyrë efektive si rezultat i mungesës së koordinimit dhe komunikimit.

Koordinimi dhe Komunikimi

Shumica e njerëzve thanë se komunitetet do të duhej të ishin më mirë të integruara në koordinimin dhe procesin e dorëzimit të asistencës. Megjithatë, kishte mendime të ndryshme për mundësinë e dhe shkallën e angazhimit të OJQ-ve vendore në këtë proces. Njerëzit kishin opinione të ndryshme rreth funksionimit efikas të autoriteteve vendore. Shumë të tjerë shprehën indinjatën me faktin se të hollat dhe asistenca nuk kanë arritur nga shërbimet e Qeverisë tek komunitetet në terren. Ekipi i dëgjimit dëgjoi vazhdimisht,

“[Agjensionet ndërkombëtare] duhet të punojnë më tepër dhe drejtpërdrejtë me njerëzit sepse përndryshe ekziston një rrezik i madh i korrupsionit.”

Shumë njerëz ishin kritikues të komuniteteve ndërkombëtare dhe efikasitetit në shpërndarjen e ndihmave dhe organizatat duket të kenë shtyre agjendat e tyre, shpeshherë edhe pa blerjet lokale. Një këshilltarë i politikës lokale tha,

“OJQ-të e angazhuara në rindërtim kanë bërë një punë të mirë por donacionet u shuan shumë shpejtë. Shumë familjeve nuk iu riparuan shtëpitë. Përveç kthimeve, nuk kishte mjaft koordinim dhe një pjesë e madhe e të hollave janë shpenzuar për punë administrative, këshilltarë dhe procedura burokratike. Autoriteteve komunale u ka munguar vullneti për tu angazhuar në kthimin e refugjatëve derisa kthimi kryesisht është shtyrë nga ndërkombëtarët.”

Të tjerët gjithashtu theksuan se as ndihma lidhur me kthime nuk ishte mirë e koordinuar. Në një rajon, një grua tha se fondet e ndara duhet të kenë mjaftuar për të ndërtuar shtëpi për të gjithë banorët e komunës së saj, dhe shtoi:

“Shumë familje mbetën pa shtëpi mbi kokë, dhe po të kishte udhëheqje më të mirë kjo nuk do të kishte ndodhur. Komuniteti ndërkombëtar duhet t'i kishte kushtuar vëmendje më të

madhe identifikimit të njerëzve të duhur [në komunitete] të cilët janë të sinqertë dhe nuk do t'i keqpërdornin fondet. Ata të cilët janë të varfër i njohin të varfrit.”

Këto kritika zakonisht ishin të ndërlidhura me mungesën e kontrollit (diskutuar më shumë në vijim) nga agjensionet ndërkombëtare dhe donatorët. Njerëzit thanë se stafi ndërkombëtarë nuk ka shpenzuar mjaft kohë në zonë për të vlerësuar situatën nga afër dhe duke e bisedimet me njerëz. Ata shpesh janë mbështetur në stafin lokal dhe institucionet lokale (p.sh. këshillat e fshatrave, autoritetet komunale apo OJQ-ët lokale), të cilat ishin të korruptuara dhe të ndikuara nga tendencat politike. Ne dëgjuam vazhdimisht për rëndësinë e lidhjeve për të marrë ndihma të duhura, dhe kjo kryesisht i referohej stafit vendor të OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare.

Një numër i njerëzve thanë ata do të merrnin ndihma më efektive nëse do të kishin pasur mundësinë që të bashkëpunonin drejtpërdrejt me stafin ndërkombëtar të agjensionve për ndihma në vend se të bashkëpunimit përmes ndërmjetësuesve. Në një bisedë, një njeri theksoi,

“Fshatarët nuk janë edhe aq të fuqishëm që të vendosin për projekte. Ndërkombëtarët duhet të punojnë drejtpërdrejtë me njerëzit lokal. Nganjëherë, komuna shumë fonde. Ndërkombëtarët duhet të vijnë drejtë këtu për të diskutuar nevojat tona.”

Një ish ministër i qeverisë theksoi se,

“Të hollat janë shpenzuar për koordinimin në mes ndërkombëtarëve, por asnjë kosovar nuk morri pjesë në këto projekte.”

Një tjetër person përshkroi shkurt rezultatin e komunikimit dhe pjesëmarrjes së mirë:

“Nëse njerëzit përfshiheshin, ata ndihen të fuqizuar. Mendoj se njerëzit ndihen më mirë në raste kur ekziston transparenca, komunikimi, dhe bashkëpunimi.”

Dy biseda me Ekipin e Dëgjimit ilustronë se sa lehtë mund të shkatërrohen komunikimi. Një grup i stafit lokal të OJQ-ës tregoi për qendrën e fondeve të komunitetit nga organizatat e jashtme:

“Interneti ka qenë dashur të jetë falas, por njerëzit u detyruan të paguanin për të. Kur pyeta [organizatat e jashtme] pse i bëni fëmijët tanë të paguajnë, ata thanë se të hollat përdoren për mirëmbajtjen e zyrës së tyre.”

Kur është pyetur organizata e jashtme për këtë qendrën shoqërore, stafi nxori dokumentet për të treguar se qendra shoqërore është financuar nga donatorë të shumtë, dhe në fakt një donator tjetër kishte financuar pjesën e internetit. Megjithatë u vë të kuptohet se të ardhurat ishin të dedikuara për mbështetjen e zyrës së qendrës shoqërore, e JO për zyrën kryesore të donatorit të huaj.

Gjithashtu u përmendën rastet e shumta të duplikimit të përpjekjeve që rezultoj si rezultat i mungesës së koordinimit në mes të donatorëve. Rasti më i shpeshtë kishtë të bënte me me sistemin e energjisë elektrike (KEK), që ishte shembull i rasteve të ndihmës keq të menaxhuar. Njerëzit përshkruan riparimin e rrymës elektrike si shërim sipërfaqësor të simptomave ku

donatorë dhe agjensione të ndryshme kanë ofruar fonde, materiale dhe përkrahje teknike për pjesët e ndryshme të sistemit. Megjithatë, pikërisht si rezultat i mungesës së koordinimit, sistemi ende nuk funksionoi si duhet dhe shumë njerëz spekuluan që i tërë sistemi mund të ishte rindërtuar me fondet e përdorura deri më tani.

Një zyrtar i një ministrie të qeverisë i përfshirë në harmonizimin e ndihmës, sugjeroi se mungesa e koordinimit dhe "fragmentimi i ndihmave" rezultuan në:

"1) Konkurrencë të padrejtë ndërmjet agjensioneve dhe OJQ-ve, 2) shumë 'vrima të zeza' pa asistencë, derisa disa rajone kishin shumë organizata duke punuar atje, dhe 3) mungesë të programeve ndërlidhëse për të lidhur fazat emergjente dhe atë të ndihmës zhvillimore."

Ai njoftoi që edhe një problem tjetër shumë serioz ishte ai ku shumë agjencione nuk kishin strategji dalëse dhe kur fondet u ishin pakësuar, ata u zhdukën, edhe pse njerëzit pritnin një asistencë më të madhe. Pastaj njerëzit kërkuan nga qeveritë lokale që t'i mbushin zbrazëtirat e mbetura, por ata shpesh nuk ishin të informuar për projektet apo nuk kishin eksperiencë pune apo buxhet të mjaftueshëm për vazhdimin e projekteve të filluara nga OJQ-ët.

Pjesëmarrja dhe Partneriteti

Lidhur me përfshirjen e komunitetit, disa njerëz thanë se proceset me më pak pjesëmarrës do të ishin më të përshtatshme gjatë fazës emergjente kur komuniteti nuk ka kapacitet për tu angazhuar plotësisht. Megjithatë, ata theksuan se më vonë përpjekjet e asistencës do të duheshin të jenë më gjithëpërfshirëse dhe cekën rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces. Një anëtar i këshillit të fshatit tha:

"Është e nevojshme për komunitetin ndërkombëtar të qëndroj në Kosovë për një kohë afatgjatë. Por ata duhet të tentojnë të ndajnë përgjegjësitë me kosovarët - kjo nuk ka ndodhur më parë. Ne deshëm të konsultohemi më shumë. Ne kemi një proverb:[Ju] nuk mund të bëni ujdi pa pronar."

Qytetarët shpesh përmendën se tani është momenti adekuat i tranzicionit në Kosovë kur ndihmat mund të shndërrohen nga ato direkte në ndihma më forma më të qëndrueshme dhe procese të zhvillimit. Ata shpesh përdornin fjalën "partneritet". Një nëpunës i ministrisë sugjeroi që "Njësitë për projektet e implementara (PIU-s)" i përdorur nga shumë donatorë duhet të eliminohet pasi që ka funksionuar si enklavë brenda institucioneve që më vonë është dashur të mbështesin po ato projekte edhe pse nuk ishin përfshirë në implementimin e tyre. Ai sugjeroi që organizatat ndërkombëtare kanë nevojë:

"të punojë më shumë brenda institucioneve, jo për to."

Një nëpunës tjetër tha,

"Ne kemi çmuar shumë ndihmat direkte pasi kemi pasur nevojë për to në atë kohë, , por tani mund t'i zgjidhim problemet vet. Tani kemi nevojë për partnerë e jo vetëm ndihma."

Disa njerëz gjithashtu komentuan se pjesëmarrja dhe partneriteti, së paku për qeveritë lokale, do të thotë më shumë se “prezenca në të njëjtën dhomë ku merren vendimet.” Një zyrtar komunal në rajonin e Gjilanit, përshkroi një projekt ku komuna ishte prezente gjatë negociatave, por ndihmat megjithatë përfunduan në duart e njerëzve të gabuar. Sipas mendimit të tij kjo ka ndodhur pasi komuna nuk është lejuar të angazhohet tërësisht. Një kontraktues i donatorëve i cili morri pjesë rregullisht në takimet ndërmjet komunës dhe donatorëve dhe organizatave të jashtme, deklaroi:

“Edhe pse ata marrin pjesë në këto takime, vendorët nuk kanë ndikim të madh.”

Njerëzit diskutuan numrin e madh të OJQ-ve ndërkombëtare që funksionojnë në Kosovë, sidomos gjatë fazës emergjente, dhe cekën se nuk kishte kontroll të mjaftueshëm mbi këto organizata. Në një numër bisedash me liderët e komunitetit dhe një me stafin lokal të një OJQ-je ndërkombëtare, ata pohuan se komunat dhe këshillat e fshatrave tani duhet ta pastrojnë “rrëmujën” e krijuar nga mungesa e koordinimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit. Kjo “rrëmujë” përfshinë përdorimin e materialeve të kualitetit të dobët për ndërtim dhe perceptimi i shpërndarjes së pa barabartë pasi organizata të ndryshme kanë ofruar “pako” të nivelit dhe tipit të ndryshëm. Në disa rajone, liderët dhe qeveritë lokale nuk posedojnë me shënime për të gjitha projektet e ofruara, por tani komunitetet kërkojnë nga komunat që ta mirëmbajnë infrastrukturën si dhe projektet e filluara nga organizatat ndërkombëtare. Kjo “rrëmujë” ishte sidomos sfiduese për qeveritë komunale pasi ato nuk kishin fonde për tu ballafaquar me këto probleme pas largimit të organizatave të huaja.

Disa qytetarë përmendën rastet kur atyre iu ka pëlqyer puna e kryer nga organizatat e huaja, sidomos në rastet kur organizatat kanë vizituar të gjithë banorët për të identifikuar njerëzit që kanë nevojë për ndihma. Një shembull tjetër specifik i koordinimit dhe partneritetit efikas kishte të bënte me krijimin e planit për të ndërtuar një shkollë të mesme në një fshat. Kryetari i departamentit për arsim dhe drejtori i një shkolle përshkruan se si në vitin 2004 ata ishin angazhuar në procesin “planifikues” i cili angazhoi të gjithë pjesëmarrësit në projektin e shkollës: mësuesit, prindërit, zyrtarët e ministrisë, dhe donatorët. Drejtori theksoi se kjo strategji ka ndihmuar shkollën të identifikoj prioritete të qarta të cilat ndihmuan në përmirësimin e rezultatit të nxënësve si dhe lehtësoi komunikimin me donatorë dhe OJQ:

“Ne kemi të gatshëm një listë prioritetesh dhe një plan afatgjatë. Krejt ajo çka ne duhet tani të bëjmë është koordinimi me komunën dhe donatorët dhe është e qartë se [ka duhet bërë për ta përmirësuar shkollën tonë.”

Gjithashtu, njerëzit ofruan shembuj të komunikimit dhe partneritetit efektiv tre-palësh, në mes të komuniteteve, komunave dhe OJQ-ve. Në këto raste komuniteti ka punuar së bashku me OJQ-të që t’i identifikojnë dhe implementojnë projektet prioritare. Shpesh u përmend se komunitetet çmojnë metodat e tilla pjesëmarrëse. Lidhur me një projekt për rindërtimin e shkollës ku komuniteti kontribuoi 30 përqind të punës dhe fondeve, një person tha:

“Pjesëmarrja jonë ishte shumë e çmuar -ne dëshiroam të jemi pjesëmarrës në këtë projekt. Edhe pse nuk ishim në gjendje të ofrojmë mbështetje financiare, ne dhamë përkrahjen morale. Kjo përkrahje ishte gjithmonë, gjithmonë prezente.”

D. Çështjet e Përgjegjësisë, Transparencës, dhe Kontrollit

Të gjithë bashkëbiseduesit e ndryshëm nga të gjitha rajonet e Kosovës ishin të mendimit për nevojën e përforcimit të përgjegjësisë, transparencës dhe monitorimit të ndihmave dhe organizatave ndërkombëtare. Një qytetar u shprehu mendimin e tij si anëtar i komunitetit:

“Kur ndërkombëtarët sjellin fondet këtu, ata duhet të jenë të kujdesshëm se ku i shpenzojnë ato dhe kujt ia dhurojnë. Ata kanë nevojë për kontroll i brendshëm...Unë s’kam kompetenca. Nuk kam qasje në komunë dhe s’kam mundësi t’i analizojë dokumentet financiare.”

Një zyrtar komunal tha se mungesa e transparencës ka rezultuar nga koordinimi dhe konsultimet joefikase me zyrat e ndryshme brenda komunës që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për qytetarë. Gjatë përshkrimit të projekteve të ndryshme lidhur me dritat në rrugë, kthimet dhe pajisjet të bujqësisë, ai theksoi,

“Ekziston një problem me harmonizimin e projekteve...Ky problem ka rezultuar sepse OJQ-të nuk na kanë konsultuar neve por kanë punuar me zyrën komunale për komunitete.”

Në përgjithësi, njerëzit ishin të pasigurt kujt t’i drejtoheshin për problemet me ndihmat që ata i kishin pranuar. Një situatë tipike kishte të bënte me përdorimin e materialit të dobët për ndërtim, dhe ndërtesa më vonë u rrënuan, por agjensioni apo OJQ-të që ofruan asistencën shpesh ishin larguar pas dështimit të projektit. Gjithashtu, ekzistonte një sens i përgjithshëm se agjensionet ”hedhën fajin”, d.m.th komuna fajëson kontraktuesin, dhe kontraktuesi ka fajësuar agjensionin ndërkombëtar që financoi projektin. Kështu tregoi edhe një person,

“Kur gjërat kanë vajtur gabimisht, ne iu kemi ankuar komunitetit ndërkombëtar. Ata thanë fajin e ka qeveria, kështu që u ankuam tek ata, dhe ata thanë jo është faji i komunitetit ndërkombëtar. Ne nuk dimë kujt t’i drejtohemi!”

Në tërë komunitetin ne dëgjuam njerëzit duke pyetur të njëjtën pyetje,

“Pse nuk u kthye ndokush?Pse ata nuk erdhën të shohin se si janë shpenzuar të hollat, se [‘farë kualiteti i ndërtimit është përdorur, dhe se kush i ka pranuar këto ndihma?’”

Njerëzit me të cilët biseduam gjithashtu kritikuan faktin se procesi i krijimit të projekteve shpesh nuk ishte transparent. Sipas tyre komunitetet nuk janë njoftuar lidhur me synimet, mënyrën se si janë zgjedhur përfituesit e ndihmave, strategjinë implementuese etj., prandaj ata nuk kanë mundur që të kenë një rol ndikues në monitorimin e implementimit. Njerëzit shpesh ishin të frustruar me paditurinë e donatorëve lidhur me projektet e asistencës. Sipas tyre donatorët nuk ishin të njoftuar me projektet e posaçme, dhe nuk iu bënte fare që të vinin nëpër komunitete e të shohin se si të hollat e tyre shpenzoheshin- dhe gjithashtu të kuptojnë nëse ato projekte ishin ndihma që kërkoheshin nga pranuesit e ndihmave.

Së bashku me çështjet e lartpërmendura të koordinimit dhe komunikimit, kishte ndryshime të opinionit lidhur me atë se kush ishte përgjegjës për të vëzhguar dhe mbështetur më tej projektet. Njerëzit shpesh ndërlidhën çështjen e përgjegjësisë me korrupsion. Kështu u shpreh një i moshuar,

“Komunat duhet t’i mbajnë kompetencat. Megjithatë, ndërkombëtarët dhurojnë të holla nëpër komuna për tu dhuruar tek OJQ tjetra. Përmes këtij procesi rritet mundësia që dikush të marrë ca të holla. Kryetari duhet të marrë përgjegjësi për zgjidhjen e saj. Ne nuk mundemi të shohim se prej nga i merr të hollat kryetari, e aq më pak ku i shpenzon ato. Kam një tregim për ju. Kur Franz Ferdinani doli në front, ai pa se trupat e tij ankoheshin për mungesën e ushqimit. Ai pyeti kalorësin nga prapa që ta bëj një top bore dhe ta përcjell përpara. Derisa arriti në front, topi i borës ishte shumë më i vogël se sa në fillim.”

Ai e barazoi topin e borës të Ferdinandit me korrupsionin në procesin e asistencës në Kosovë, dhe u ankua se kur anëtarët e komunitetit ankoheshin në komunë, komuna përgjigjej se nuk mund të bënte asgjë, dhe kjo vazhdonte në të gjitha hallkat e burokracisë.

Reflektime mbi domethënien e këtyre temave për organizatat humanitare ndërkombëtare

Arsyet për ”problemet” në dorëzimin e asistencës në Kosovë të përshkruara më lartë, duket të jetë shkaktuar nga një numër i madh faktorësh, përfshirë: politizimin e ndihmave, presioni për shfrytëzim të shpejtë i fondeve pa përqendrimin në zhvillim të qëndrueshëm, numri i madh i organizatave dhe konkurrenca ndërmjet tyre, dhe tensioni ndërmjet nevojës dhe dëshirës për të ndërtuar kapacitetin e institucioneve vendore duke i përfshirë ato në implementim dhe vëzhgim të asistencës, si dhe aftësia e tyre si struktura të reja që ta bëjnë këtë në mënyrë efikase.

Ekipi i dëgjimit zbuluan se gjatë bisedave qytetarët vendorë u fokusuan më tepër në ndihmat materiale të bashkësisë ndërkombëtare, posaçërisht ato që i kanë pranuar gjatë fazës emergjente. Ata pohuan se investimet për ndërtim të kapaciteteve të organizatave dhe institucioneve vendore nuk janë [‘muar aq sa duhet ndoshta sepse këto përpjekje janë të vazhdueshme dhe më pak vizibile.

Për më shumë, derisa njerëzit në përgjithësi kritikuan qeverinë lokale si të korruptuar, të paafte dhe të pasinqertë, Ekipi i Dëgjimit vërejti se këto institucione mund të jenë bërë viktime të fajësimit nga të tjerët. Fakti që këto institucione janë duke u përballuar me sfidën jo vetëm të ndërtimit të kapaciteteve institucionale për përmbushjen e nevojave të qytetarëve, por gjithashtu edhe me riparimin e tollovisë së krijuar nga organizatat ndërkombëtare dhe lokale, të cilat nuk kanë planifikuar dhe koordinuar si duhet punët e tyre nëpër komunitet, atëherë kjo e bënë punën e tyre edhe më sfiduese. Kjo nxitë një cikël të dobësimit të institucioneve vendore dhe krijim të mosbesimit ndërmjet atyre dhe komuniteteve, dhe gjithashtu rëndon dilemën e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me atë se me kënd dhe si të punojnë këto organizata.

II. Kush merr ndihma

A. Faktorët Politik Ndikojnë në Marrjen e Ndhimave

Njëra prej çështjeve që u diskutua nga kishte të bënte me politizimin e procesin të asistencës, posaçërisht kur autoritetet lokale janë të angazhuara. Një shqiptar i Kosovës tha,

“Nëse nuk je anëtar i ndonjë partie ose nuk ke shokë ose familjarë në administratën komunale, atëherë e ke vështirë të marrësh ndonjë asistencë. Duhet të jesh anëtar i [partisë politike] për të marrë ndonjë asistencë. Fillimisht ndihma shkon tek anëtarët e partive politike, pastaj tek romët, dhe pastaj serbët.”

Qytetarët përmendën shpesh problemin se duhesh të kesh lidhje për të marrë asistencë. Edhe pse stafi ndërkombëtar nuk ishte zakonisht i implikuar në këto çështje, ata ishin në mënyrë indirekte përgjegjës për shkak të monitorimit jo adekuat të stafit vendorë dhe partnerëve lokalë, dhe prezenca jo adekuate në terren. Një person tha:

“Unë kam shumë lidhje, por unë kam pritur nga ndërkombëtarët që ta rregullojnë shtëpinë time. Mënyra se si ata i kanë marr vendimet se kush merr çka nuk ishte transparente. Nëse ke lidhje atëherë është lehtë të marrësh asistencë. Unë kam pritur se do të ketë ndonjë mbikëqyrje ose një komision për ti shqyrtuar vendimet, por nuk e kam parë këtë.”

B. Ndhimat Përqendrohen tek Grupet e Veçanta Etnike, Komunitetet Multi-etnike, ose të Kthyerit

Njerëzit në të gjitha rajonet treguan për përqendrimin e ndihmave tek grupet e veçanta etnike, komunitetet multi-etnike dhe te kthyerit, duke thënë se ata shpesh janë ndier të përjashtuar dhe se asistencë nuk është ofruar në bazë të nevojave të njerëzve. Shumë njerëz folën për ndryshimin e prioritetëve të agjensioneve financuese dhe OJQ-ve për t'i favorizuar grupet e posaçme, posaçërisht pas fazës emergjente. Për shembull, serbët e Kosovës shpesh ndiheshin se shqiptarët e Kosovës merrnin të gjitha fondet, përderisa shqiptarët e Kosovës ndiheshin se serbët e Kosovës ishin përfituesit kryesorë të asistencës ndërkombëtare. Të tjerët ndiheshin se të kthyerit kishin përparësi në mënyrë jo të drejtë, duke thënë:

“Familjet të cilat nuk janë zhvendosur kurrë janë shumë të frustruara sepse nuk janë pjesë e ndonjë projekti – të kthyerit mbështeten por ata që nuk janë larguar kanë mbetur anash. Ata janë të pakënaqur dhe mendojnë se askush interesohet për ta.”

Një person tjetër tha:

“Para pesë muajve ne shkuam për të biseduar me një agjension ndërkombëtar. Ne kërkuam nga ata që të ndihmojnë familjet e varfra të cilat nuk ishin të zhvendosura, por neve na u tha se kjo është e pamundur. Ne thamë: ‘Atëherë çka duhet të bëjmë ne për të marr asistencë, të dalim jashtë Kosovës dhe të kthehemi prapë?’”

Përfaqësuesit e minoriteteve etnike më të vogla gjithashtu kanë vërejtur se komuniteti ndërkombëtar anon më shumë ka serbët e Kosovës:

“Nëse Serbët e hapin një organizatë, atëherë ata do të marrin fondeNuk e di nëse ndonjë organizatë ashkallike që ka marrë ndonjë veturë, por di që disa serbë kanë marrë.”

Disa përfaqësues të minoriteteve thanë se serbët po merrnin asistencë të dyfishtë, nga UNMIK-u si dhe nga qeveria serbe, përderisa shkalit jo, psh, qasja në pensionet e tyre serbe pa i paguar taksat me vite.

Një lider i ashkalive thoshte se ishte i shqetësuar se disa grupe etnike minoritare ishin të mbledhura bashkë nga donatorët dhe agjensionet e ndihmave, zakonisht të referuara shkurt si “RAE.” Në përgjigjen se a ka ndonjë identitet të zakonshëm si RAE, ai u përgjigj:

“Janë 3 nacionalitete. Në njëerën anë, janë ashkallitë dhe egjiptasit, dhe pastaj romët. Dy të parat nuk kanë asgjë të përbashkët me romët, përveç problemeve ekonomiko-sociale ... është gabim, është kundër të drejtave humane të na grupojnë neve bashkë. Ne e ndiejmë veten të ofenduar. Është sikurse ti vendosësh serbët, goranët dhe turqit bashkë. Ne ashkallitë vetëm dëshirojmë të përfaqësojmë vetveten, por jemi të detyruar nga donatorët të përfaqësojnë të gjithë në komunitetet RAE.”

Ai shtoi se propozimet financohen vetëm nëse të tre komunitetet janë të përfshira, kështu që ata ishin të detyruar ti prezantojnë problemet në emër të tre grupeve. Në të njëjtën kohë, një OJQ ashkallike sugjeroi se ata mund ta përmbushin kuotën RAE shpesh të kërkuar nga agjensionet ndërkombëtare duke i përfshirë ose punësuar anëtarët e ndonjërit grup, edhe pse kjo zgjidhje nuk ishte prezantim i vërtet i diversitetit që kërkohej nga donatorët. Anëtarët e tjerë të grupeve etnike minoritare shtuan:

“Nuk ka mundësi punësimi për romët, ashkallitë, dhe egjiptasit (RAE) në institucionet komunale ...Askujt nuk ja di për neve të punësohemi. Ne e kemi zyrën për përfaqësuesin e RAE në komunë prej kohës kur UNMIK – u ishte administrator, por nuk ka pasur ndonjë përparim.”

Një tjetër çështje që është përmendur shumë kishte të bënte me ndihmat që kishin cak komunitetet multietnike, shpesh duke i harruar ato një-etnike. Disa njerëz në një komunitet thanë:

“Për të marrë ndihmë, jo vetëm që komuniteti juaj duhet të ketë shumë grupe etnike, ata duhet edhe të kenë probleme më njëri tjetrin gjithashtu!”

Të tjerët folën rreth multiethnicitetit dhe pajtimit thjeshtë si një “rregull e lojës” për të marrë ndihma. Një anëtar i këshillit të komunitetit shqiptar i tha Ekipit të Dëgjimit për një delegacion që kanë dërguar për të bindur serbët e zhvendosur për tu kthyer në shtëpitë e tyre. Kur Ekipi i Dëgjimit e pyeti se pse ata janë të vendosur që të kthehen serbët, ai tha:

“sepse atëherë ne do të marrim më shumë ndihma.”

Dy pronarë të tjerë të dyqaneve diskutuan rreth shkollës, shtëpisë së shëndetit dhe rrjetit elektrik që kishte marrë fshati, duke thënë

“Ne kemi marrë tërë këtë ndihmë sepse fshati është multietnik. OJQ-ët i përmbushnin kushtet e tyre. E kemi dëgjuar këtë në televizor.”

Shumë njerëz ngritën çështjen e shpërndarjes së asistencës në mes të grupeve dhe komuniteteve duke përmendur termet “paanësisë: dhe “drejtësi”. Një rekomandim që kemi dëgjuar disa herë ishte që ndihmat të shpërndahen në mënyrë të drejtë, edhe pse, natyrisht, definicioni i “drejtësisë” në këtë rast është subjektiv. Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve deklaruan se perceptimi i shpërndarjes të padrejtë të ndihmave ka penguar përpjekjet e pajtimit dhe ka mundësi që ta nxisë konfliktin në mes të grupeve etnike. Një shqiptar i Kosovës tha,

“Nëse i ndërtoni 50 shtëpi serbe atëherë ata gjithashtu duhet të ndërtojnë 50 shtëpi të shqiptarëve të djegura nga po ata serbë. Shqiptarëve iu janë dhënë kulme, dyer, dritare, dhe disave parkete. Serbëve iu është dhënë gjithçka – të ardhura, ushqim dhe shtëpi. Është vështirë të pajtohem nëse situata qëndron kështu ...Ne nuk kundërshtojmë që serbët të marrin ndihma, por në dëshirojmë që ndihma të ndahet në mënyrë të barabartë.”

Megjithatë, kishte edhe të tjerë që e shihnin qëllimin e ndihmesës multietnike si pozitive. Disa njerëz ndiheshin se komuniteti ndërkombëtar kishte një rol të vazhdueshëm në mësimin e njerëzve si të vlerësojnë diversitetin dhe të jetojnë së bashku në mënyrë efektive, dhe se bashkëjetesa ndonjëherë duhet të imponohet në të ardhmen afat-shkurte. Një lider fetar serb sugjeroi se,

“Organizatat ndërkombëtare duhet t’iu tregojnë shqiptarëve se ata do të përfitojnë nga një shoqëri multietnike. Bashkësia ndërkombëtare duhet t’iu thotë shqiptarëve se nëse serbët kthehen dhe punojnë, atëherë madje edhe për shqiptarët do të jetë më mirë... në Kosovë çdo ditë ka më pak serbë, ata e shesin pasurinë e tyre, njerëzit nuk shohin ndonjë arsye për të jetuar këtu. Mendoj se duhet të gjindet një arsye për t’i inkurajuar ata që të qëndrojnë në Kosovë!”

Në anën tjetër, një shqiptar i cili ishte i zhvendosur dhe ende nuk ka mundur të kthehet në shtëpinë e tij, tha:

“Derisa shqiptarët të kthehen, serbët nuk do të jenë të qetë!”

Kush merr ndihma

Një nga anëtarët e Ekipit të Dëgjimit të nacionalitetit shqiptar theksoi nevojën e asistencës ndërkombëtare për të promovuar multietnicitetin. Ai tha se një Kosovë multietnike është shumë e rëndësishme për te dhe shtoi se pa serbët, Kosova do të

“ishite si një vend ku njerëzit do të vozitnin vetëm vetura Volksfagen! A mund ta paramendonin sa e mërzitshëm mund të jetë kjo?”

Ekipi i Dëgjimit sugjeroi se problemi me caktimin e pranuesve të ndihmave ka të bëjë më shumë me transparencë dhe nevojën për më shumë diskutim rreth prioriteteve financuese dhe plan projekteve, në mënyrë që popullata të mos e keqkuptoj synimin e organizatave të huaja. Nga pikëpamja e drejtorëve të agjensioneve ndërkombëtare të ndihmave me të cilët jemi takuar në Kosovë, ndërrimi i prioriteteve të financimit është normal, por ata shprehën rrezikun që mund të sjellin zbrazëtira e mëdha ku njerëzit nuk do të arrijn t’i marrin ndihmat e nevojshme.

III. Zhvillimi Ekonomik

Gati në të gjitha bisedat, njerëzit treguan për nevojën e një zhvillimi më të qëndrueshëm ekonomik. Qytetarët thanë se krijimi i vendeve të punës për të rinjtë është prioritet kryesor me të cilin Kosova ballafaqohet sot. Siç tha një person,

“Rinia në Kosovë, ata ulen në kafene, nuk bëjnë asgjë, derisa kafet e tyre i paguajnë prindërit. Ata nuk kanë arsye që të mos shkojnë dhe kërkojnë fatin e tyre, të gjejnë punë, por në dëshirojmë që ata të rrinë. Për të ardhmen tonë, ne duhet të gjejmë mënyra për t’iu siguruar punë atyre që të qëndrojnë në Kosovë.”

Papunësia në Kosovë vlerësohet të jetë afër 50% dhe rreth një e treta e popullatës jetojnë në varfëri.¹⁰ Shumë njerëz cekën se papunësia ka shkaktuar migrim ekonomik, si në kryeqytetin Prishtinë, ashtu edhe jashtë Kosovës. Shumë njerëz në Kosovë ende varen nga të ardhurat dhe përkrahja ekonomike nga anëtarët familjarë që punojnë në Evropë, SHBA, dhe vendet e tjera. Një zyrtar i ministrisë që merret me shqiptarët e diasporës tha

“...shumë (në diasporë) janë lodhur duke dukë dërguar të holla në Kosovë që 20 vjetë, dhe ata tani janë duke iu thënë familjeve të tyre se familjarët duhet të gjejnë zgjidhje tjera...disa nga ata duan të investojnë në biznese dhe të krijojnë vende të punës, por ende nuk ka ligje të mirëfillta për të garantuar investimet e tyre.”

Ai dhe të tjerët e lidhin faktin e ekonomisë së pazhvilluar me shtyrjen e finalizimit të statusit të Kosovës, duke vënë re se investitorët dëshirojnë të shohin finalizimin e statusit kështu që statusi ligjor i investimeve të tyre të jetë i qartë. Disa njerëz thanë se korrupsioni dhe krimi i organizuar, duke përfshirë edhe trafikimin e mallrave dhe njerëzve, dhe pasiguria dhe brishtësia politike gjithashtu kanë ulur besimin e investitorëve të mundshëm. Disa njerëz mendojnë se qeveria e Kosovës (si dhe donatorët që përkrahin atë si dhe reformat e tanishme ekonomike) kanë nevojë të bëjnë më shumë për t’i mbrojtur bizneset e vogla dhe posaçërisht fermerët që nuk mundën të konkurrojnë me produktet e vendeve tjera. Fermerët gjithashtu thanë se ata nuk kanë sigurim ose ndonjë mbrojtje kundër katastrofave natyrore, që mund t’i shkatërroj të mbjellat e tyre.

Njerëzit gjithashtu diskutuan çështjet e procesit të privatizimit të mbikëqyruar nga komuniteti ndërkombëtar, duke sugjeruar se fabrikat duhet të rihapen. Ata gjithashtu shprehën bezdinë e tyre

¹⁰ Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës 2006 http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/hdr_eng.pdf

se vlerësimi i pronës shtetërore nuk ka qenë i drejtë. Njerëzit cekën se ende ekzistojnë disa prona dhe fabrika të cilat ende i takojnë shtetit, dhe këto ende nuk mund të përdoren për të krijuar më shumë mundësi ekonomike përderisa të mos zgjidhet statusi i Kosovës.

Shumica e njerëzve me të cilët kemi biseduar theksuan se prioriteti i agjensioneve ndërkombëtare për zhvillim është dashur të ndryshoj më herët nga ndërtimi i shtëpive në krijimin e mundësive ekonomike. Një person sugjeroi:

“Një kontribut më i madh do të ishte ndërtimi i fabrikave. Krijimi i vendeve të punës krijon standarde më të mira të jetës. Organizatat ndërtuan 20 shtëpi, dhe pastaj edhe 10 më shumë, por pa punë është vështirë. Nuk mund ta hash shtëpinë tënde. Mardhëniet e komunës dhe KEK-ut (kompania elektrike) nuk janë të mira. KEK-u nuk mund t’i punësoj të gjithë njerëzit për këtë arsye kemi shumë të papunësuar në rrugë që krijojnë probleme. Ne duhet të punësojmë rininë. Nuk ka asistencë financiare për shkollim. Kemi pasur kushte më të mira në ish Jugosllavi. Prindërit po humbin vendet e tyre të punës. Ne mund t’i ikim këtij problemi nëse ndërkombëtarët do të investonin në fabrika dhe jo vetëm në shtëpi.”

A. Mundësitë ekonomike të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme.

Në diskutimet e mëparshme lidhur me faktin se ndihmat ndërkombëtare nuk kanë përmbushur nevojat vendore, disa cekën edhe trajnimin e papërshtatshëm që është ofruar nga agjencionet humanitare, si psh: trajnime për frizer për më shumë se 50 femra në fshat. Një numër i njerëzve thanë se këto programe trajnimi nuk kanë krijuar mundësi për të cilat ata kanë shpresuar, dhe për më shumë, njerëzit ishin të zhgënjyer dhe në njëfarë mase edhe të ofenduar nga këto ndihma duke thënë:

“Kjo ishte e tëra për çka ne jemi të aftë sipas komunitetit ndërkombëtar?”

Të tjerët thanë se janë ndiher të ofenduar kur OJQ-ët ndërkombëtare sollën ndihma si mikro-kredi në vlerë prej vetëm 50 euro dhe programe trajnimi në bazë të punë të vendeve më pak të zhvilluara (shumë njerëz i përmendnin vendet Afrikane si shembull). Ata ishin të zhgënjyer që agjencionet humanitare nuk kanë gjetur kohë të kuptojnë burimet dhe aftësitë e vendit, dhe t’i dizajnojnë programet e tyre në mënyrë të duhur:

“Tentimet e tyre ishin të mira, por OJQ-ët kurrë nuk kanë bërë llogari ose vlerësime – të hollat kanë mund të përdoren më mirë.”

Një numër i njerëzve përmendën se edhe pse mikro-kreditë ishin bërë një burim i famshëm i asistencës ndërkombëtare dhe kishin krijuar qasje në kapital, në realitet, norma e interesit e këtyre kredive ishte shumë e lartë dhe se shumica e kredive ishte shumë e vogël. Një person sqaroi:

“Ata na ofrojnë neve 2,000 euro për zgjerim të një biznesi... (ai e drejton gishtin ka një makinë)... Kam paguar 12,000 euro për këtë makinë për shtypjen e maicave e cila i punëson 5 njerëz. Kur i kërkova 10,000 euro, ata më refuzuan por pastaj ata janë gati të

Japani 15,000 euro për një konferencë e cila vetëm prodhon rekomandime. Ka shumë trajnime dhe shumë pak kredi!”

Shumë njerëz thanë se kërkohet më shumë investim në bizneset e mesme që do t’iu mundësonte ndërmarrësve, fermerëve, etj të krijojnë punë të reja. Në anën pozitive sa i përket mikro-kredive, disa thanë se këto fonde tek e fundit ishin më shumë transparente sesa grantet e dhëna përmes komunës.

Prokurimi i mallrave gjithashtu ishte një çështje, ku disa njerëz thanë se komuniteti ndërkombëtar kishte bërë një punë të mirë në stimulimin e ekonomisë së vendit duke u bazuar në burimet brenda Kosovës. Sidoqoftë, të tjerët diskutuan se si kontraktuesit ndërkombëtarë shpesh kanë sjellë pajisje dhe logjistikë të blera në vendet e tyre (më së shumti nga Evropa), dhe se një mundësi serioze kishte munguar duke mos institucionalizuar politikën që kërkojnë prokurim brenda Kosovës. Në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin e një periudhe të gjatë, një numër i njerëzve sugjeroi:

“Në të ardhmen, mendoj se do të jemi më të mirë në të gjitha aspektet. Na duhet punësim më i madh. Nëse dëshirojmë një shtet ne duhet të gjithë të punojmë dhe jo vetëm disa nga ne. Shteti ndërtohet nga njerëzit, jo nga politika.”

“Qasja më e mirë ndaj pajtimit është investimi ekonomik dhe krijimi mundësive multi-etnike për punësim, e jo vetëm të mbajmë fjalime për të drejtat e minoriteteve.

B. Çështja e strukturave paralele

Shumë njerëz janë ankuar se ata të cilët punojnë në institucionet paralele të përkrahur nga qeveria serbe (zyrtarët komunalë, mësimdhënësit, etj) marrin rroga më të larta. Për shembull, një serb i cili ishte i punësuar në një zyre komunale të përkrahur nga UNMIK-u sqaroi se kolegët e tij që kanë punuar në zyre komunale të përkrahura nga qeveria serbe merrnin prej 1,000 deri 1,500 euro / muaj, përderisa ai merrte vetëm rreth 350 euro/muaj nga qeveria kosovare (të përkrahur nga UNMIK-u). Kur është pyetur pse ai punon për më pak, ai tha se i pëlqen mjedisi multi-etnik i punës. Ai tha se edhe pse ai është konsideruar si tradhtar në komunitetin serb pasi punon në komunën e përkrahur nga UNMIK-u, ka pasur të tjerë që kanë dëshiruar punën e tyre. Ai gjithashtu pranoi se pagat më të larta nga qeveria serbe nuk janë të drejta pasi ka shumë shqiptarë që jetojnë në kushte të këqija, edhe pse shumë prej tyre kanë “kontribuar” në sistemin serb për shumë vite.

Një grua shqiptare, e frustruar se mësimdhënësit shqiptarë (të paguar nga qeveria Kosovare) janë të paguar vetëm rreth 200 euro/muaj, përderisa mësimdhënësit serbë paguheshin rreth 800 euro/muaj¹¹, tha:

¹¹ Nuk mundëm ti konfirmojmë shifrën e €800 që ajo i sugjeroi. Një raport i OSBE-s i vitit 2003 Për strukturat paralele tregon se mësimdhënësit Serb të Kosovës mund të paguan €500 nëse pagat nga qeveria Serbe dhe Kosovare janë të kombinuara. http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698_en.pdf (f.32). Edhe një tjetër raport i UNESKO-s i vitit 2004 konfirmon shifrën e €500: <http://www.unesco.org/iiep/PDF/pubs/kosovo.pdf>. (f. 124)

“Dje i kishin të gjitha, dhe sot i kanë të gjitha.”

Disa njerëz kanë fajësuar komunitetin ndërkombëtar për lejimin e standardeve dyfishe në dhënien e pensioneve dhe asistencës sociale nga qeveritë Serbe dhe Kosovare, duke thënë se ata prisnin agjencionet ndërkombëtare për të bërë më shumë në shfrytëzimin e burimeve dhe mundësive. Për shembull, një Shqiptarë i moshës së mesme i cili punonte në një fabrikë pronë e shtetit para lufte, ankohej se Serbët të cilët punonin aty më të tani i merrnin pensionet e tyre (rreth 300 euro/muaj) nga qeveria Serbe si dhe paga nga UNMIK-u, përderisa ai merrte vetëm 40 euro/muaj mirëqenie sociale nga qeveria Kosovare dhe nuk kishte qasje në pensionin e tij.

Disa storie të ngjashme Ekipet e Dëgjimit i kanë dëgjuar në rajone tjera ku një Shqiptarë i moshës së mesme sqaroi se kishte aplikuar për asistencë sociale, por ai duhej që fëmijët e tij të jenë nën moshën 5 vjeç për tu kualifikuar, dhe mendoi se kjo është e padrejtë pasi që kishte punuar për hekurudhat për më shumë se 41 vjet dhe se kishte kontribuar në sistemin pensional nga i cili nuk merrte ndonjë përfitim. Ai dhe të tjerët thanë se ata i prisnin këto çështje që të zgjidhen kur statusi i Kosovës të vendoset, dhe se komuniteti ndërkombëtar do të mundësonte marrje të barabartë të pensioneve dhe përfitimeve të tjera.

C. Praktika e punësimit nga organizatat ndërkombëtare

Sa i përket vendeve të punës të krijuara nga asistencë e organizatave ndërkombëtare, disa njerëz kanë shprehur brengosje më mënyrën sesi agjencionet ndërkombëtare kanë dërguar njerëz për të punuar në rajone nga të cilat ata nuk kanë ardhur. Ata thanë se kjo krijon shumë probleme, si psh.: se vendet e punës merren nga vendorët; njerëzit me besnikëri të ndryshme dhe kuptimin të dobët të komuniteteve punojnë atje; dhe mënyra sesi agjencionet ndërkombëtare i punësojnë njerëzit është i bazuar në projekt pas projekti, dhe kjo nuk ofron siguri të punës ose stabilitet për stafin lokal.

Të tjerët përmendën mospërputhjen e pagave në mes të pagave të agjensioneve ndërkombëtare dhe ato të qeverisë vendore. Ata cekën se kjo ka shkaktuar një ekonomi të brishtë e cila vështirë se do të jetë e qëndrueshme pas largimit të organizatave ndërkombëtare. Anëtarët e Ekipit të Dëgjimit që ishin staf lokal i OJQ-ve ndërkombëtare thanë se ata personalisht kanë përfituar shumë gjatë punës së tyre me agjencionet ndërkombëtare pa marrë parasysh se sa ka zgjatur periudha e punësimit të tyre. Ata gjithashtu thanë se kanë mësuar gjuhë të reja, iu është dhënë mundësi në mësimin e aftësive të reja përmes trajnimeve, kanë zhvilluar një etikë të re të punës, kanë udhëtuar, dhe kanë ndërtuar marrëdhënie përtej kufijve kulturor.

D. Roli i kapaciteteve dhe përpjekjeve vendore

Investimet vetanake të kosovarëve në rindërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë kanë qenë të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh se shumë shqiptarë të Kosovës janë kthyer nga Evropa dhe vendet e tjera për të hapur biznese. Shumë prej tyre të cilët kanë pasur mundësinë të studiojnë ose punojnë jashtë vendit gjithashtu janë kthyer në Kosovë. Për shembull, një shqiptar i cili ka marrë bursë për të vazhduar studimet e larta në SHBA thoshte se të gjithë kolegët e tij janë kthyer, duke potencuar se ishte një vendosmëri e madhe për të bërë një ndryshim dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një “Kosove të re.”

Disa njerëz përmenden se ekziston një vendosmëri e madhe dhe kapacitet tek një pjesë e të rinjve që duhet të përqendrohem. Një anëtarë i një komuniteti nënvizoi:

“Ne e kemi popullatën më të re në Evropë dhe ne duhet ta shfrytëzojmë atë.”

Edhe një avokat i moshës së mesme sugjeroi:

“Më shumë para duhet të investohen tek të rinjtë të cilët mund të bëjnë ndryshime – njerëzit e vjetër janë në rrugën e tyre dhe nuk ka kthim mbrapa. Pse nuk ti lejojmë të rinjtë dhe të vjetrit të konkurrojnë bazuar në merit? Është koha për të bëjmë ndryshime tani.”

Ndjenja e përgjithshme se asistenca ndërkombëtare ka shpëtuar jetë por jo adresimin e “problemeve sistematike” është dëgjuar në Kosovë, si në Ushtrimet tjera të Dëgjimit. Disa njerëz thonë se është më e rëndësishme zhvillimi i ekonomisë tani kështu që kur të caktohet statusi, njerëzit nuk janë të zhgënjyer kur situata ekonomike nuk ndryshon shpejt, por vetëm e rrit mundësinë për dhunë. Një lider i mirënjohur sugjeroi:

“Asgjë nuk funksionon më mirë sesa punësimi që e ushqen zhvillimin dhe ambicien.”

IV. Rreth Zhvillimit Institucional

A. Ndërtimi i Kapaciteteve të Qeverisë

Shumë njerëz ishin të shqetësuar me funksionimin e dobët të institucioneve qeverisëse të Kosovës, të cilat kanë marrë shumë asistencave të ndërkombëtare. Njerëzit treguan për konfuzionin lidhur me ligjet dhe rregulloret në mes të niveleve lokale dhe qendrore, dhe ankoheshin për problemet e marrjes së vendimeve, mungesës së transparencës, dhe burokracisë.

Njerëzit gjithashtu treguan edhe për jo efikasitetin e sistemit të drejtësisë dhe problemi i qasjes në dokumente, si dhe nevoja për të ndryshuar mentalitetin brenda sistemit, pra kalimi nga mënyra e të menduarit socialist me burokraci të madhe, mungesë të iniciativës, çështjet e zgjidhura me vonesë, etj. në një qëndrim me fokus në rezultate. Disa njerëz kanë fajësuar komunitetin ndërkombëtar për vendosjen e këtij sistemi, dhe kanë pritur që UNMIK-u ta përdorë fuqinë për të zbatuar ligjet dhe t’i parandaloj abuzimet e pushtetit.

Shumë njerëz kanë thënë se ata nuk kanë vetëbesim në institucionet ose politikanët për shkak të shumë çështjeve të diskutuara në këtë raport: korrupsioni, mungesa e transparencës, komunikimi dhe koordinimi i dobët, politizimi i proceseve të asistencës, etj. Një kryetar komune tha:

“Është bërë një punë e shkëlqyeshme sa i përket multikulturës. Ne ndihemi më të sigurt, mund të lëvizim lirshëm, nuk kemi probleme të jetojmë bashkë. Tani, problemi është ne mes të komuniteteve dhe institucioneve. Për këtë arsye duhet shumë për të punuar në këtë drejtim.”

Njerëzit janë të shqetësuar me sistemin e tanishëm politik dhe kjo i bën ata të ndihen se nuk janë pjesë e këtij sistemi dhe si rezultat shumë më pak marrin pjesë në proceset politike. Disa K-shqiptarë theksuan se sistemi i mbyllur i votimit (ku njerëzit votojnë për parti, jo për kandidat) është joefektiv sepse lejon një shpërhapje të përgjegjësive, ku njerëzit fajësojnë partinë në vend se t'i mbajnë përgjegjës politikanët si individë. Disa K-shqiptarë thanë:

“Politikanët në komuna flasin rreth asaj se çka ata mund të marrin, jo çka mund të bëjnë.”

“Askush nuk ndihet si përfaqësues ose si i përfaqësuar. Për shembull, kryetari i komunës së Prishtinës nuk është bile as nga ky qytet.”

“Demokratizimi ishte një supozim fals – ata nuk kanë krijuar një sistem ku njerëzit mund ta përdorin këtë tipar. Partitë zgjedhin ata njerëz prej të cilëve mund të përfitoj partia, jo njerëzit. Ekziston një luftë në mes të partive politike e cila reflektohet tek popullata.”

Udhëheqësi i një thinktenu tregoi se në të dy gjuhët shqip dhe serbisht, nuk ekzistojnë fjalë të ndara për “politics” dhe “policy (shqip: politikë). Ai thoshte se kur ai trajnonte disa nga partitë politike,

“Kur u pyeten se çka prodhojnë partitë politike?’ askush nuk tha ‘politika.’”

Përderisa kuota për participimin e femrave në parti politike ka ngritur numrin e femrave në politikë, disa femra brenda dhe jashtë qeverisë treguan se kjo ishte vetëm një gjest sipërfaqësor ndaj pabarazisë gjinore sepse në realitet ato ende janë të limituara në pushtet dhe ushtrim të ndikimit të tyre. Ato thanë se ka pak femra në pozita të larta udhëheqëse dhe se nuk ka femra që përfaqësohen në Ekipin e Unitetit për të negociuar statusin final me qeverinë serbe dhe KB.

Për më tepër, disa njerëz thanë se përderisa disa burokratë në shërbimin civil kanë pasur trajnime, pa rritje të pagave, shumë janë larguar dhe janë në prag të largimit, dhe kjo po shkakton humbjen e diturisë institucionale. Një zyrtar ministror tha se përderisa shumë është investuar në trajnime nga komuniteti ndërkombëtar, këto investime do të humbin dhe se,

“Korrupsioni do të jetë dhjetëfish më i lartë nëse punojnë për biznese sepse ata e dinë se si funksionon administrata dhe i njohin njerëzit dhe do ti përdorin lidhjet e tyre – ky është një rrezik i madh!”

B. Administratorët Ndërkombëtarë

Shumë është diskutuar dhe shkruar për sukseset dhe dështimet e administratës së UNMIK-ut. Shumë njerëz ishin të frustruar më transferimin e ngadalshëm të kompetencave nga administrata ndërkombëtare tek institucionet vendore. Në të njëjtën kohë, mungesa e besimit në institucionet vendore dhe ka nxitur disa të këmbëngulin që prezenca e komunitetit ndërkombëtar ende mbetet e nevojshme. Disa të tjerë kanë sugjeruar se stafi ndërkombëtar ende duhet të shërbej si “mbikëqyrës,” përderisa shumica pohuan se ata duhet të jenë këtu vetëm si “këshillues.”

Këto çështje janë gjithashtu të lidhura me rrëmujën e krijuar nga funksionimi i njëkohshëm i strukturave paralele të administratës dhe qeverisë (psh. UNMIK-u, kosovarët dhe serbët). Ekziston droja se në situatë të tillë konfuze, njerëzit përdorin çfarëdo ligje ose rregullore që i'u përshatet më shumë dhe se nuk ka ndonjë mekanizëm për qartësimin e rregulloreve dhe për gjykimin e përgjegjësive së njerëzve sipas një standardi të vetëm. Për më shumë, disa njerëz u shprehën se Kosova është rast i veçantë, dhe ata cekën se bashkësia ndërkombëtare vetëm ka imponuar një strukturë administrative, posaçërisht sistemin e drejtësisë, pa marrë fare parasysh çështjet dhe nevojat specifike të shoqërisë kosovare. Të tjerët u shprehën se gjithmonë ka ekzistuar një konkurrencë në mes të ekspertëve juridikë amerikanë dhe evropianë, të cilët nuk kanë angazhuar vendorët sa duhet gjatë krijimit apo reformimit të rregulloreve.

C. Zhvillimi i Shoqërisë Civile

Disa njerëz theksuan se planifikimi i financimit nga donatorët për shoqërinë civile nuk ka qenë i përshatshëm për faktin se tani ka më pak resurse përkundër ngritjes së kapaciteteve vendore. Ata cekën se në të kaluarën kur ka pasur më shumë mbështetje financiare për OJQ-të, këto organizata nuk kanë arritur t'i absorbojnë këto fonde si duhet. Një hulumtues dhe këshilltar i politikave u shpreh se pasi agjensionet ndërkombëtare kanë insistuar në implementimin e projekteve gjatë financimit të OJQ-ve,

“Tani është krijuar një shoqëri projektuese, jo shoqëri civile.”

Ai shtoi se tani duhet të ketë përqendrim në ndërtimin e organizatave përkrahëse dhe mbikëqyrëse pranë OJQ-ve vendore të cilat zbatojnë projekte dhe ofrojnë shërbime, dhe se kjo do ta forconte shoqërinë civile dhe qeverisjen në Kosovë.

Disa njerëz cekën se trajnimet lidhur më zhvillimin e shoqërisë civile dhe partive politike ishin pozitive; mirëpo, ata theksuan një nevojë për më shumë përqendrim në këto çështje, si dhe në ndërtimin e kapaciteteve përkrahëse dhe mbikëqyrëse brenda shoqërisë civile. Një anëtar i një komuniteti u shpreh:

“Ne duhet të punojnë në ndërtimin e themeleve të demokracisë dhe stabilitetit. Institucionet nganjëherë nuk mundën të bëjnë shumë vetëm nëse popullata nuk bashkëpunon dhe nuk e përkrah punën e tyre...(komuniteti ndërkombëtar mundet) t'i ndihmoj njerëzit të jetojnë në siguri, t'iu ofroj punësim, të angazhohen në pajtim dhe kështu nuk do të ketë probleme.”

Në Mitrovicën e veriut dhe në enklavat serbe, disa njerëz përshkruan problemet logjistike dhe burokratike për të marrë fonde për organizatat vendore nga komuniteti ndërkombëtar. Ndër të tjera u cek fakti se financimi duhet të kalojë përmes shumë organeve para se të arrijë tek organizatat vendore. Këto procedura u konsideruan si të zgjatura dhe të mërzitshme. Të tjerët shprehën vështirësitë në themelimin e OJQ-ve në këto treva:

“Është vështirë për tu regjistruar në Prishtinë dhe në duhet të regjistrohemi që të konsiderohemi nga donatorët. Gjithashtu është vështirë të bëhet regjistrimi në Serbi.. dhe ne nuk kemi donatorë serb (përveç shtetit serb).”

OJQ-ët e tjera serbe than se ishin vetëm disa “projekte të përbashkëta” për dallim nga numri i premtuar i tyre dhe ata:

“Shpesh janë ndier si të shfrytëzuar, si derri i 13, i cili është dashur të shpezohet. OJQ-ët ndërkombëtare na kanë humbur kohën dhe do të ishte më mirë sikur të punojmë si partnerë.”

Disa njerëz u shprehën se para influksit të ndihmave ndërkombëtare të cilat filluan në vitin 1999, në Kosovë ka ekzistuar një shoqëri civile aktive e cila ka luajtur rolin e shtetit përmes institucioneve paralele shqiptare të financuara kryesisht nga popullata dhe diaspora shqiptare. Udhëheqës i një OJQ-je të njohur tha se pasi që shumë ish udhëheqës të shoqërisë civile tani punojnë në qeveri,

“Ekziston një filantropi individuale për rastet individuale të bamirësisë, por ende ka pak përkrahje institucionale dhe edhe më pak mirëkuptim për rolin e shoqërisë civile.”

Të tjerët u shprehën se tradita e solidaritetit dhe kontributit në komunitet janë humbur pas influksit të asistencës ndërkombëtare, dhe kjo rezultoi në një konkurrencë të madhe për ndihmë. Shumë njerëz u shprehën se shpirti vullnetar i cili ka ekzistuar në komunitetin shqiptar është shkatërruar edhe më tej nga disa organizata që paguan “vullnetarë” për të participuar në projekte dhe komisione.

Disa njerëz sugjeruan se një nga kontributet që mund të bëjë komuniteti ndërkombëtar është investimi i mëtutjeshëm në zhvillimin e shoqërisë civile. Një person theksoi se roli më produktiv për komunitetin ndërkombëtar në të ardhmen mund të jetë:

“...krijimi i vetëdijes tek qytetarët (dhe) të shërbej si urë në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë kosovare.”

Reflektimet Përfundimtare dhe Pyetje të Tjera

Disa tema të përgjithshme dhe pikëpyetje rrjedhën nga ky ushtrim i dëgjimit lidhur me përmirësimin e efikasitetit të asistencës ndërkombëtare në përgjithësi. Këto janë pyetje sfiduese pa përgjigje të menjëhershme. Megjithatë, ne i shqyrtojmë këto pikëpyetje si çështje të rëndësishme në mënyrë që të kontribuojmë në përqendrimin e vëmendjes së punëtorëve të angazhuar në këtë sferë:

- Ekziston një tension i pandarë në mes të ndërtimit të kapaciteteve vendore, posaçërisht institucionale, dhe përmbushjes së nevojave të menjëhershme për komunitetet. Si të punohet me institucionet vendore në mënyrë efektive, duke marrë parasysh çështjet e kapacitetit, mungesës së koordinimit, dhe korrupsionit?

- Këto biseda shtrojnë pyetjen se si të ndryshohen kulturat politike me rrënjë të thella në mjediset e pas-luftës. Anëtarët e ekipit u shprehën se Ballkani zbulon disa sfida të veçanta në ndërrimin e mentalitetit të ish Jugosllavisë, ku ekziston një shpërhapje e përgjegjësisë individuale dhe burokraci e madhe, në një sistem demokratik me përgjegjësi dhe kontrolle të duhura. Anëtarët diskutuan domethënien e këtyre tipareve sa i përket ndryshimit të sjelljeve dhe qëndrimeve individuale dhe kolektive. Ky efekt pastaj shfaqet brenda mjedisit (psh. vendi i punës, komuniteti, etj). Është e nevojshme të arrihet tek një kuptim më i mirëfilltë i këtyre çështjeve dhe se si ato ndërlidhen me procesin e zhvillimit dhe punën e bashkësisë ndërkombëtare. Këto janë tranzicione të mëdha kulturore, dhe Ekipi i Dëgjimit zbuloi se ato kërkojnë kohë.
- Një lloj tjetër i ndryshimit kulturor i cila gjithashtu u shfaq në disa biseda ka të bëjë me varësinë nga ndihmat dhe përshtypja se kulturë vullnetare ka ndryshuar pas bombardimeve të NATO's dhe futjes së agjensioneve humanitare, posaçërisht kur aq shumë agjensione kanë dhënë gjëra falas. Prandaj, u shtrua çështja se: si të plotësohen nevojat e komunitetit, posaçërisht në një fazë emergjente, pa krijuar varësi dhe pa ndikuar negativisht në vlerat tradicionale pozitive të një shoqërie?
- Është me rëndësi për ta marrë parasysh kapacitetin e njerëzve për të participuar gjatë fazave të ndryshme të asistencës. Ekipet e Dëgjimit iu referuan përhapjes së të menduarit me “stomak”, dhe nga fakti se shumë shqiptarë ishin të traumatizuar dhe të turpëruar gjatë fazës së emergjencës nga përvojat e hidhura e shndërrimit në refugjatë dhe largimi në vendet tjera. E njëjta gjë ndodhi edhe me shumë serbë të cilët u larguan me forcë ose kanë ikur nga hakmarrja kur janë kthyer shqiptarët. Këto përvoja traumatike kanë ndikuar në kapacitetin e tyre për të participuar dhe ndihmuar vetveten, mënyra sesi janë sjellë si marrës, dhe ndoshta mundësia për të kursyer, dhe ndjenja e të drejtës - - një reagim logjik njerëzor i largimit dhe traumave. Prandaj shtrohet pyetja, si t'i përgjigjeni emergjencave në atë mënyrë që: 1) të krijohen baza themelore për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndryshim të thellë shoqëror; 2) nuk e shkatërron vullnetarizmin dhe kualitetet e tjera pozitive shoqërore; dhe 3) nuk krijon varshmëri, përderisa në të njëjtën kohë pranohet gjendja emocionale e njerëzve të cilët kanë vuajtur dhe kapaciteti i tyre për tu angazhuar në proceset pjesëmarrëse?
- Ekziston një nevojë për të menduar rreth ndikimit të ndihmave me qëllime politike, dhe të mos “grumbullohen” anëtarët e grupeve etnike minoritare së bashku pa dallim. Një lëvizje tjetër kulturore që disa njerëz e cekën është nevoja për tu fokusuar në krijimin e identitetit “kosovar”. Ndërtimi i paqes duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës. Një anëtar i Ekipit të Dëgjimit theksoi se bashkësia ndërkombëtare duhet të *“përqendrohet në ndërtimin e shoqërisë, dhe jo domosdoshmërisht në ndërtimin e paqes.”*